Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupġtina - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 DHE 26 JANAR 2015

SA PLENARNE SEDNICE SKUPĠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRĢANE 23. I 26. JANUARA 2015. GODINE

JANAR - JANUAR
2015

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike,
8. Debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona za zabranu udruģivanja u oruģane konflikte,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o elektronskom nadgledanju lica, kojima je ograniļeno kretanje odlukom suda ili Panela za uslovno oslobaĽanje,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-051 o spreļavanju konflikta interesa u obavljanju javne funkcije,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o prisluģkivanju elektronskih komunikacija,
8. Skupģtinska rasprava o ilegalnoj migraciji graĽana Kosova.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar ministra,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, ata që kanë qenë më herët deputetë - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Kuptohet për ju ministrat, që nëse e merrni fjalën, do ta merrni pasi të hapet debati dhe në qoftë se ka nevojë, deputetët kanë të drejtë në replikë në fjalën tuaj.

Po fillojmë pa humbur kohë. Nga Partia Demokratike, në emër të Grupit Parlamentar, a është dikush? Nuk është. Atëherë fjalën e ka, sipas paraqitjes, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!
Përshëndetje për ministrat,
Kolegë deputetë,
Unë do ta ngre një çështje, e cila është harruar dhe kemi edhe mjaft ministra që e kanë harruar, ose edhe kryeministri, le ta dinë që ka ndodhur një masakër në Burgun e Dubravës.

Ajo masakër dhe njerëzit që e kanë harruar, tani thuhet 15 vjet pas luftës, dikush thotë 15 vjet pas konfliktit, ministrat thonë nuk ka pasur asnjë konflikt, nuk e di, kam qenë me një zgafelle, nuk e dinë nëse ka ndodhur diçka apo jo, dhe na fyejnë edhe na përdhunojnë në formën më të ulët. Këtu e kemi edhe fotografitë e një masakra, ku janë mbi 120 të vrarë, mbi 300 të plagosur e të burgosur, dhe askush deri më sot nuk e ka ndërmarrë asnjë masë.

E kemi ngrehur çështjen edhe në Kuvendin të Kosovës. Kemi marrë edhe rekomandime nga Kuvendi i Kosovës. I kemi dhënë propozime këtij Kuvendi. Është angazhuar edhe EULEX-si për këtë çështje, por edhe ai nuk e ka marrë një vendim dhe dhunuesit, poshtëruesit, fyesit edhe sot na thonë që nuk dinë asgjë.

Për mua dhe për njerëzit që kanë qenë pjesë e kësaj masakre, e kësaj dhune dhe këtij terrori, janë të papranueshme fyerjet e tilla që vijnë nga ministrat për shqiptarët, për nënat, për fëmijët, për prindërit, për të gjithë ata që e kanë kaluar pjesën e luftës.

Sot thuhet që ne nuk dimë gjë, kur kemi me qindra e qindra viktima. Është turp që ministrat e tillë të thonë kështu. Por, për mua është absurde kur e shoh se çfarë gjendje. E

kemi Qeverinë në neglizhencë, jo e gatshme të marrë masa, prandaj ky është një absurdi i kohës, në të cilin jetojmë ne si Kosovë.

N±se Kosova ±sht± ósui generisô, veprimet e tilla nuk do t± jen± ósui gerenisô. Veprimet e tilla janë të dënueshme në çdo vend të botës, prandaj duhet të jenë edhe këtu te ne.

Prandaj, kërkoj që masakra e Dubravës për ministrat e tillë të jetë një shembull që ta shohin çfarë ka bërë regjimi i Milosheviqit dhe ata që e mbështetin edhe sot në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!
Unë flas në emrin tim, jo në emër të grupit. Në fakt, dua ta shfrytëzoj rastin, meqë e kemi k±tu ministrin e Sh±ndet±sis± p±r tôia kujtuar dhe p±r ta pyetur n± lidhje me mamografin mobil. Besoj se të gjithë i keni parë shpesh raportimet nëpër media, raportime mjaft negative, ndonjëherë edhe sulme ndaj Grupit të Grave Deputete për faktin që ai nuk po funksionon.

Thjesht, dua tôia kujtoj ministrit t± Sh±ndet±sis±, q± Grupi i Grave Deputete ka kryer pun±n e vet. Ka qen± nj± pun± t±r±sisht vullnetare dhe q±llimmir±, n± m±nyr± q± tôu vij± në ndihmë të gjitha grave për skrinimet e nevojshme.

Ndërkohë po shohim që mamografi mobil, i cili ka kushtuar, është blerë me ndihmën e donatorëve dhe të njerëzve vullnet mirë nuk po funksionon. Zoti ministër, ju lutem na raportoni se pse nuk po funksionon, pse Ministria e Shëndetësisë nuk po i përmbahet memorandumit të nënshkruar me Grupin e Grave Deputete dhe kur do të fillojë të funksionoj, pra ta përmbushë qëllimin e këtij, qëllimi i cili ka të bëjë me lëvizjen e mamografit mobil nëpër të gjitha komunat e Kosovës, në mënyrë që ai të shkojë te grat dhe ato ta kryejnë shërbimin shëndetësor për të cilin është dedikuar.

E kam lexuar një komunikatë nga Spitalit të QKUK-së, por ta them të drejtën më duket tërësisht e pajustifikueshme që kjo punë ende ka dështuar. Dua ta dijë, a po e merr Ministria me seriozitet këtë, e nëse jo pse? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit! Unë deklarimin e kam në emër të Grupit të Lëvizjes ñVet±vendosjeò

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Javën e kaluar, siç jemi të gjithë dëshmitarë, pra deri të dielën pasdite, i tërë spektri politik i Kosovës pajtohej që ka një rrugë të vetme nëpërmjet së cilës mund ta shpëtojmë ñTrep-±nò nga kthetrat e Dhom±s s± Ve-ant± dhe ta vendosim at± n± funksion t± zhvillimit ekonomik të Kosovës e të mirëqenies së qytetarëve. Ajo rrugë e bënte ñTrep-±nò nd±rmarrje publike. I gjith± spektri politik at±her± mendonte k±shtu, p±rve-

një subjekti që nuk është i Kosovës, kreatura e Beogradit - Lista serbe. Por, të hënën në mëngjes, gjërat ndryshuan: si Lista serbe filluan të mendojnë edhe PDK-ja dhe LDK-ja. Të hënën, Qeveria dhe deputetë e saj na thanë që kjo nuk është rruga dhe u tërhoqën. E me k±t± t±rheqje n± m±nyr± indirekte than± q± ñTrep-aò nuk do t± vendoset n± funksion të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së qytetarëve, por në funksion të negociatave me Serbin±, ashtu si- k±rkoi Beogradi. Sepse k±shtu, sipas tyre, po u shp±tuaka ñTrep-aò, fillimisht me zgjatjen e afatit për riorganizimin dhe likuidimin e saj.

Kështu flisnin edhe në vitin 2011. Ju kujtohet të gjithëve që keni qenë këtu, atëherë kur ky ligj ishte miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Atëherë thoshin se me këtë ligj po e shp±tojn± ñTrep-±nò.

Të premten e javës së kaluar na thanë se duhet ikur nga ky ligj p±r ta shp±tuar ñTrep-±nò, t± h±n±n pastaj na than± se duhet ndryshuar k±t± ligj p±r ta shp±tuar ñTrep-±nò.

Pra, -far±do mase q± t± nd±rmarrim, ñTrep-aò qenka e shp±tuar, q± sipas k±saj logjike i bie q± ñTrep-aò nuk qenka fare e rrezikuar.

Arsyetimi i Qeverisë ishte ai kujdestar, i misioneve ndërkombëtare këtu që prej UNMIK-ut e deri te ICO-ja. ñTrep-aò ±sht± problem kompleks. Kujdes, pra, po thon± problem, e jo pasuri. Ka pretendime të shumta për borxhe dhe si e tillë gati se është e parimëkëmbshme.

Isa Mustafa, në arsyetimin e tij në këtë sallë, madje nuk i quajti pretendime fare, por detyrime, duke i pranuar kështu këto pretendime madje edhe pa vendosur gjykata.

E dimë të gjithë që një pjesë e konsiderueshme e këtyre pretendimeve vijnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, diku mbi 140 milionë euro, të cilat Qeveria ia ka dhënë ñTrep-±sò n±p±r faza t± ndryshme dhe p±r q±llime t± ndryshme.

Po ashtu e dinë të gjithë që një pjesë e pretendimeve janë të vetë punëtorëve minatorë në formën e pagave t± papaguara nga ñTrep-aò, pun±tor± k±ta t± cil±t deri dje ishin n± grev± n± zgafelle me k±rkes± t± vetme p±r ta shnd±rruar ñTrep-±nò n± nd±rmarrje publike.

Po ashtu e dim± q± ka edhe pretendime, shumica prej t± cilave vijn± nga vitet e ó90-ta, pretendime këto të cilat i kanë, qoftë kompanitë nga jashtë, apo kompanitë dhe institucione shtet±rore nga Serbia, t± cilat pretendojn± se ñTrep-aò u ka borxh dhe t± cilat pretendojnë se kanë pronësi mbi të. Ato janë, p.sh: ñMytilineosò nga Greqia, e cila thotë se ka kontrat± 517 milion± me ñGenexò. Kjo kompani pretendon se nga kontrata e nënshkruar ka realizuar 44 milionë euro.

Q± i bie se n±se ne sot, si Republik± e Kosov±s, themi qe ñTrep-aò paska pretendime dhe duhet tôi shikojm± ato, at±her± i bie se ne jemi t± gatsh±m tôi pranojm± k±to pretendime, t± cilat jan± realizuar n± ñTrep-±ò gjat± administrimit t± dhunsh±m q± e ka pasur n± kohën e okupimit të dhunshëm që i është bërë Kosovës nga regjimi i Milosheviqit. Pra, i bie që ne po e pranojmë legjitimitetin e regjimit të Milosheviqit. Natyrisht që Qeveria e

Republik±s s± Kosov±s n± asnj± m±nyr± nuk b±n q± tôi pranoj± k±to borxhe. Dhe, si t± till±, Qeveria e Republik±s s± Kosov±s, domosdoshm±risht duhet ta shpall± ñTrep-±nò ndërmarrje publike, në mënyrë që pastaj si shtet të ballafaqohemi me çfarëdo pretendimesh dhe të punojmë së bashku në mënyrë që këto pretendime të mos realizohen dhe t± mos shnd±rrohen n± detyrime q± mund tôi ket± ñTrep-aò.

Të martën, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka sjellë prapë Ligjin për ndërmarrjet publike, të ndryshuar dhe të plotësuar ,në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ai nuk është diskutuar në këtë seancë. I është dorëzuar Komisionit për Zhvillim Ekonomik, por nuk është diskutuar ende aty. Mirëpo, ky ligj i ka dy ndryshime rrënjësore që e bëjnë iden± p±r ñTrep-±nò plot±sisht t± ndryshme prej asaj t± jav±s s± kaluar. Ndryshimi i par± është që kur flitet për të drejtën e Qeverisë, që ndërmarrje të caktuara ose pjesë të nd±rmarrjeve t± caktuara shoq±rore tôi kthej± n± publike, aty ±shtë futur edhe një klauzolë -kushtëzimi që u jepet e drejta komunave që ta kushtëzojnë këtë nacionalizim, apo këtë shndërrim të ndërmarrjeve shoqërore në ndërmarrje publike.

Ky është dëmi i parë dhe ky është mjeti i parë ose hapi i parë, nëpërmjet të cilit po themelohet pushteti ekzekutiv i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. Dhe, -±shtja e dyt±, thuhet se ñTrep-aò do t± rregullohet me nj± ligj dhe strategji t± ve-ant±, por askund nuk thuhet se do të jetë ndërmarrje publike me këtë ligj dhe strategji dhe askund nuk thuhet fare se kur do të vijnë ky ligj dhe kjo strategji në Kuvendin e Kosovës. Pra, kjo e tregon shum± qart± se -far± q±llimi ka Qeveria me ñTrep-±nò. Duan q±, n± njërën anë, për të gjitha ndërmarrjet shoqërore, të cilat po i kërkon Serbia, tôua japin t± drejtën të vendosin komunat me shumicë serbe në territorin e Kosovës, ndërkohë që, në an±n tjet±r, sa i p±rket ñTrep-±sò, meqen±se ±sht± nd±rmarrje e ve-ant± dhe po e trajtojm± si ndërmarrje të veçantë, përfundimin për të ta dakordojnë me Qeverinë e Beogradit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Visar! Fjalën e ka zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!
Të nderuar qytetarë,
I nderuari kryesues i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Nuk do të duhej që kryeministri i vendit ta ndiente veten rehat dhe të qetë pas pezullimit të grevës së minatorëve. Por, nga kjo situatë shtrohet pyetja: A do të jeni në gjendje që ta mbani së paku kësaj radhe premtimin që pas një muaji Qeveria e Kosovës do tôi realizoj± kërkesat e grevistëve dhe ata të mos jenë të detyruar që prapë të dalin në grevë? Po ashtu, a do t± jeni n± gjendje q± pas nj± muaji t± vendosni ju p±r fatin e ñTrep-±sò, e jo Beogradi.

Me të vërtetë është shumë e rëndë dhe për keqardhje situata e ditëve të fundit, e cila po mbret±ron n± minierat e ñTrep-±sò.

Kjo situatë të kthen pas në kohën kur minatorët tanë mbanin greva për të drejtat e tyre dhe kur kërcënoheshin nga regjimi i Milosheviqit, e kurrë nuk do të mund ta paramendoja që në një situatë po thuajse të njëjtën të gjendeshin njerëzit të cilët kanë sakrifikuar dhe po sakrifikojnë gjithçka që kanë dhe në këtë ditë kur Kosova konsiderohet që të jetë shtet i pavarur.

Deri më tani ka kaluar një çerekshekull nga greva e mbajtur e vitit ó89. Vall±, a duhet t± kalojë edhe një çerek shekulli e minatorët të presin që të dalë dikush nga shteti dhe të merret me hallet e tyre.

Të nderuar qytetarë,
T±rheqja e Ligjit p±r gjigantin ñTrep-aò ±sht± b±r± me q±llim q± kjo t± b±het -±shtje e diskutimeve ndërmjet palës serbe dhe palës kosovare në Bruksel. E ju e dini fortë mirë se çfarë të mirash na kanë sjellë deri më tani bisedimet nga Brukseli.

Edhe kjo është shumë e qartë, pasi deri më tani këtu është vendosur ajo çka është kërkuar nga Beogradi, konkretisht ajo çka është kërkuar nga Lista serbe.

Kur do t± vet±dijesohemi q± tôi ruajm± pasurit± tona komb±tare dhe tôi mbrojm± interesat e vendit, por edhe të qytetarëve?

ćsht± koha tôi themi jo tjet±rsimit t± ñTrep-±sò. Grupi Parlamentar ñNismaò është kundër -do vendimi q± merret n± d±m t± ñTrep-±sò, por edhe n± d±m t± minator±ve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj, në emër të Grupit, e ka fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues i seancës,
Të nderuar deputetë,
Ministra,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ajo që ka ndodhur këto ditë nëpër media dhe në opinionet publike është diçka që asnjëherë nuk e kam menduar që në jetën time të përjetoj, apo të dëgjoj fjalë nga politikanët, të cilët thonë që deputetët manipulojnë me grevistët.

Po ju them se nuk ka proces në Kosovë, po nisem nga vetja dhe nga të gjithë deputetët këtu ndoshta, që nuk kanë marrë pjesë aktive në çështjen që është madhore, që quhet Kosovë, dhe del dikush dhe ofendon apo mundohet të manipulojë me çështje të tilla, le të mbetet në ndërgjegjen e tyre. Ajo që ka ndodhur për tërheqjen e Ligjit nga ky Parlament, nga komisioni përkatës parlamentar, është diçka e papranueshme, jo vetëm për mua, por për të gjithë qytetarët e Kosovës, është e papranueshme për vetë punëtorët e ñTrep-±sò dhe është e papranuar për gjithë politikën e ndershme. Të hiqet një ligj për të cilin kemi qenë unanim ta miratojmë, është diçka absurde dhe le të mbetet në ndërgjegjen e atyre që mendojnë kështu.

Ajo që tani është kontrabanduar nga kjo Qeveri, është edhe më e keqe. Thuajse po duan ta fillojnë procedurën e ndryshimit të Ligjit për ndërmarrjet publike. Lexojeni nenin 11.3, i cili e shnd±rron ñTrep-±nò n± nd±rmarrje komunale, i cili ñTrep-±nò e b±n pazar t± komunave gjegjëse në territorin në t± cilin gjenden nj±sit± p±rkat±se t± ñTrep-±sò. A nuk është kjo propagandë, a nuk është ky mashtrim, a nuk është kjo dallavere e Qeverisë?

Prandaj, besoj që qytetarët e Kosovës, besoj që grevistët e kanë lexuar dhe do ta lexojnë me vëmendje. Dhëntë Zoti q± ñTrep-aò t± mos shnd±rrohet n± nj± tragjedi t± cil±n askush nuk w do. E kanë mbrojtur atëherë kur është dashur. Kam qenë edhe student në Këshillin Organizativ kur kemi hyrë në protesta, prandaj të jeni të bindur se grevistët nuk mund të manipulohen as nga Pali, as nga Mustafa, as nga Qeveria, sepse me mundin e tyre e kanë mirëmbajtur dhe kanë dhënë djersë për këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën

EMILIJA REDĢEPI: Hvala predsedavajuĺi!
Poġtovani predstavnici Vladinog kabineta,
Kolege poslanici,
Poġtovani graĽani,
Svedoci smo velike migracije naġih graĽana u poslednjih nekoliko meseci prema zapadno evropskim zemljama. To je ovo alarmantno stanje zadesilo i Boġnjaļku zajednicu, ġto direktno utiļe na proces obrazovnog sistema u nastavi na Bosanskom jeziku, odnosno smanjuje se broj uļenika u osnovnim ġkolama, te se celokupni nastavni proces odvija u jako teġkim uslovima. Pre svega mislim na nedostatak finansijskih sredstava za finansiranje ġkola, koji je direktno vezan sa brojem uļenika, te je budġet neprihvatljiv za ġkole koje imaju mali broj uļenika, odnosno osnovne ġkole u ruralnim mestima, posebno u Ģupi i Podgori. Te naredne ġkolske godine ukoliko se administrativno uputstvo Ministarstva obrazovanja ne promeni, preti gaġenje nastavnog procesa u veliki broj ġkola. Zatim, ne manji problem je ograniļenost broja zaposlenih radnika, odnosno odnos broja zaposlenih radnika i broj uļenika.

Prema administrativnom uputstvu broj 22/2013, formula za nastavni proces za Boġnjaļku zajednicu je 1:14, odnosno jedan nastavnik i 14 uļenika. Ako uporedimo sa statistiļkim podacima, koji govore da se svake godine broj uļenika smanjuje za 500, onda je ovaj odnos za naġu zajednicu neodrġiv i politiļki neprihvatljiv, i on se mora promeniti i biti najviġe 1:8. Sve ovo gore izneto preti naruġavanju kvaliteta i odrġivost nastavnog procesa u Boġnjaļkoj zajednici.

Ako se i dalje bude primenjivala ova formula za financiranje ġkola, kao i za broj zaposlenih u nastavi, onda Íe veĺ u septembru mesecu ove godine pojaviĺe se veliki broj viġka nastavnika i nefunkcionalnost odrġavanje nastave na Bosanskom jeziku. Uz saglasnost svih direktora osnovnih ġkola i koordinatora u nastavi na Bosanskom jeziku u opġtini Prizren, dostaviĺemo u pismenoj formi reġenje sa preporukama za odrġivost nastave na Bosanskom jeziku, odnosno obratiĺemo se Parlamentarnoj komisiji za obrazovanje, Parlamentarnoj komisiji za prava i interes zajednica i zahtevati od ministra Obrazovanja da izmeni administrativno uputstvo broj 33/2013 i 22/2013 i delovati u

skladu sa ļinjeniļnim stanjem na terenu i doneti odluku u ġto kraĺem vremenskom periodu, kako ne bi doġlo u pitanje opstanka nastavnog procesa u Boġnjaļkoj zajednici i oļuvanje sluġbenog bosanskog jezika na lokalnom nivuo. Zahvaljujem!
KRYETARI: Faleminderit! Zonja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Faleminderit! Flas n ëemrët të grupit.
Poġtovani poslanici,
Poġtovani ministri,
Jedan od vrlo velikih i ozbiljnih problema sa kojima se suoļava Boġnjaļka zajednica je problem nostrifikacija diploma, taļnije zahtev za nostrifikaciju diploma od strane institucije naġe drġave i nemoguĺnost nostrifikovanje istih, jer je proces nostrifikacije zaustavljen, i to predstavlja jedan od glavnih i najvaġnijih razloga direktne diskriminacije Boġnjaka na Kosovu. Naveġĺu vam jedan primer: u Graļanici lekar sa diplomom steļenom na teritoriji Srbije nesmetano se prima na posao, radi usavrġava sebe, pomaġe drugima, a njegov kolega Boġnjak koji je zavrġio studije na istom univerzitetu nije konkurentan na trġiġtu rada, naravno van Graļanice i Ġtrpca ne moġe da konkuriġe za posao, jer se njemu traġi nostrifikovana diploma. Ovo direktno navodi na zaključak da se na Kosovu, u jednom njegovom delu, priznaju diplome steļene u Srbiji, a u drugom delu ne.

Izmeľu Kosova i Srbije uveden sistem reciprociteta u priznavanju diploma. Iz poznanih izvora znam da u Srbiji nije priznata nijedna diploma steļena na Kosovu, a Kosovo je dobilo 5 diploma nostrifikovanih preko Brisela Boġnjaļkih studenata medicinara, onako kako je zahtevalo procedura nostrifikovanja koja Ministarstvo obrazovanja i Ministarstvo zdravstva ne priznaju, i ti studenti Boġnjaci i dalje su bez moguĺnosti da konkuriġu za posao.

Boġnjaļki doktoranti koji su svoje doktorske disertacije stekli u drġavama regiona, ne mogu biti profesori. Oni koji su se do sada bavili time, teraju se sa posla, bez obzira na duġinu radnog staġa, jer nemaju nostrifikovanu diplomu, i ne mogu je nostrifikovati. U nastavi na Bosanskom jeziku ne moġemo viġe donositi profesore iz Bosne, jer im je potrebna viza, koju vrlo teġko dobijaju.

Molim Ministra, gospodina Arsima Bajrami, i naġu ministarku gospoľu Edita Tahiri, kojoj se javno zahvaljujem na svu energiju koju je uloġila do sada na reġavanju ovog problema, da zajedno sa nama pronaľe neko prolazno reġenje za veliki broj Boġnjaka koji imaju ovaj problem. Stanje u mojoj zajednici je vrlo alarmantno. Danas na dnevnom redu imamo taļku iseljavanja kosovara sa Kosova, a ja mislim da je ovaj jedan od najveĺih problema zbog kojeg mi gubimo mlade Boġnjake intelektualce koji odlaze van trbuhom za kruhom, a ovo bole za nas joġ i veĺa, s obzirom na to do ove diskriminacije koje se direktno tiļe samo Boġnjaka na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën

FLORA BROVINA: I nderuar kryesues!
Kolegë dhe kolege,

E kam kërkuar fjalën shumë më herët për shqetësimin që e kam. Tani e dy javë opinioni ynë, përkatësisht qytetarët janë të shqetësuar dhe këtë shqetësim po e shfaqin nëpërmjet protestave masive. Ky shqetësim është i kuptueshëm dhe i arsyeshëm, sepse u shkaktua nga një deklaratë e pamatur dhe ofenduese e anëtarit të Kabinetit të Qeverisë Isa Mustafa.

E shqetësuar dhe e ofenduar jam personalisht si humaniste, si deputete në mandatin tim të pestë në Kuvendin e Kosovës, si ish-kryesuese e Komisionit për personat e pagjetur dhe të zhdukur gjatë luftës. Në kohën e vet, ky komision bëri disa punë të rëndësishme në gjetjen dhe afirmimin e çështjes së personave të pagjetur, madje takime ndërkombëtare, konferenca ndërkombëtare dhe e detyroi këtë Kuvend që ta nxjerrë deklaratën dhe rezolutën dhe ta përmirësojë ligjin në favor të familjeve të personave të pagjetur.

Nuk them se u bë shumë, por u hap një perspektivë dhe një shpresë për gjetjen e personave të pagjetur dhe të zhdukur gjatë luftës, si për shembull: u gjetën afro 1 000 kufoma në Batajnicë, pastaj në Petrovo Selo, u kuptua për zhdukjen e kufomave dhe bartjen me frigorifer, zhdukjen e tyre në ujërat e Danubit. Megjithatë, shumë gjëra nuk u bënë. Ndër to, nuk u zbatua pika nr. 1 e Rezolutës të nxjerrë në vitin 2004, ku thuhet: ñMe Serbin± nuk ka bisedime para se ajo zyrtarisht nuk t± k±rkoj± falje p±r vrasjet, zhdukjet, masakrat, shpërnguljen masive dhe me dhunë, për gjenocidin në Kosovë.

Kjo nuk ndodhi dhe ne hymë në bisedime pa këto kushte me Serbinë edhe pa zbardhjen e fatit të pagjeturve, edhe pse e dinim saktë se Serbia i ka këto shënime, shembull konkret - gjetja e kufomave në Batajnicë, në poligonin e ushtrisë serbe.

Kjo çështje nuk u vu në rend dite në Bruksel. Shteti ynë dhe bashkësia ndërkombëtare nuk pat±n forc±, nuk pat±n as vullnet q± tôia imponojn± Serbis± k±rkim-faljen dhe si një hap të domosdoshëm drejtëkomunikimit, fqinjësisë, paqes së domosdoshme, si një edukatë qytetare, si një të vërtetë. Kjo nuk ndodhi as 16 vjet pas përfundimit të luftës, as pas bisedimeve në Bruksel, të cilat u quajtën të suksesshme. Beogradi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit!
Të nderuar kolegë deputetë dhe ministra,
ćsht± e v±rtet± se ñTrep-aò ±sht± nj± -±shtje shum± komplekse dhe ±sht± e v±rtet± se q± në fillim të këtij sesioni, edhe Qeveria, edhe ne jemi përballuar me një situatë komplekse dhe të ndërlikuar, të cilën duhet ta menaxhojmë gjithsesi në drejtimin e duhur. Unë me këtë rast, në emër të grupit dëshiroj të përshëndes vendimin e minatorëve që të dalin nga zgafellja dhe q± n±p±rmjet nj± dialogu tolerant, nj± dialogu t± argumentuar, tôi gjejm± zgjidhjet më të mira, të cilat nuk mund të bëhen brenda 24 orëve as për një kohë, por duhet nj± koh± reale q± k±to tôi adresojm± n± m±nyr±n e duhur, sepse, fatkeq±sisht, k±to 15 vjet nuk janë adresuar siç duhet.

Sa u përket kredive, ato përbëjnë një shqetësim për të gjithë neve, por Qeveria nuk mund t± thot± se do tôi pranoj± kredit±, e as nuk do tôi pranoj± kredit±. Pik±risht kjo ka qen± edhe një nga arsyet lidhur me kreditë dhe problemet që duhet të definohen më mirë që ne edhe në komision, kur e kemi shtuar variantin e parë, disa prej nesh, duke i përfshirë edhe ata që po flasin sot, kemi theksuar se kreditë, moratoriumi ynë, duhet të këqyren edhe një herë, para se ai ligj, që ka qenë ligji i parë në procedurë të aprovohet, Prandaj, çfarë mund të bëjë Qeveria rreth kredive, është se duhet të sigurojë një legjislacion të mirë, kualitativ.

Gjyqësori duhet ta zbatojë atë legjislacion, me të cilin kreditë e arsyeshme aprovohen në procedurë gjyqësore, por kreditë që përbëjnë një blof, të cilat e kanë krijuar një huti, do të refuzohen në atë procedurë, por Qeveria dhe institucionet natyrisht që përgatitin dokumentacion, sikur edhe Ministria. Ministri është duke punuar besoj në atë drejtim, por nuk po e shoh sot k±tu. Ka qen± mir± q± ai tôi jap± sqarimet se -far± ±sht± duke punuar.

U përmend edhe ligji që ka ardhur tash nga Qeveria. Ai ka ardhur në komision dhe ne do ta trajtojmë me vëmendje shumë të duhur. Ju lutem, po flasim, prandaj mos ndërhyj! Çështja e komunave që u përmend, e unë e kam parë këtë me një shqetësim, ajo ka hyrë aty në një pjesë, por ajo pjesë ka të bëjë me komunat dhe interesat e tyre. Sa i përket ñTrep-±sò, as nuk do t± vendos± komuna veriore e Mitrovic±s, as komuna jugore e Mitrovic±s. P±r ñTrep-±nò do t± vendos± Kuvendi i Kosov±s. Kjo duhet t± jet± e qart±. T± gjithë ata që nuk e dinë këtë dhe dëshirojnë më tej të përhapen shqetësime, mendoj që nuk i shërbejnë diskutimit tolerant.

Komunat do të jenë në nivel të funksioneve të tyre. Asnjë ligj nuk do të kalojë në këtë Kuvend apo, besoj që nuk do të lejojmë asnjë prej nesh, që komunat të bëhen shtete dhe të vendosin për pasuritë nacionale. Kjo është shumë e qartë.

Edhe në ligj, në qoftë se e lexojnë ata që po flasin sot, duhet të shohin se neni që e rregullon se ñTrep-aò rregullohet me ligj t± ve-ant±, domet h±n± i p±rjashton normat tjera t± atij ligji, pra edhe komunat q± t± vendosin p±r ñTrep-±nò. Pra, ai nen ku p±rmenden komunat, sôka t± b±j± me ñTrep-±nò- ñTrep-aò thuhet se rregullohet me ligj t± ve-ant±, prandaj mos i shqetësoni qytetarët, ju lutem.

Qëllimi i tërheqjes, mendoj se është specifikuar në mënyrën e duhur nga kryeministri, nga ana ime, kur e kam arsyetuar amendamentin. Natyrisht, që në procesin e tërheqjes janë interferuar edhe shumë njerëz dhe duke përfshirë edhe Vuçiqin e të gjithë ata që kanë dashur të ndërtojnë kapital për vete, por, Qeveria e Kosovës nuk i bien vendimet në nervozën e Vuçiqit apo të dikujt tjetër, por në mënyrë të studiuar dhe të përgjegjshme, në interesin më të mirë publik dhe në interesin më të mirë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!
Ka ditë që në Gjakovë, në Fushë-Kosovë, në Ferizaj, Gjilan, Pejë, Deçan, Istog, Dardanë, Krushë, Malishevë, Lipjan e Prishtinë, e kudo tjetër nëpër Kosovë, qytetarët po protestojnë. Ata, ndër të tjera, kanë një kërkesë për kryeministrin e Kosovës, që ta

shkarkojë një ministër të Qeverisë që ai udhëheq, i cili në vazhdën e poshtërimeve që po ia b±n Kosov±s, ka fyer edhe n±nat e viktimave t± luft±s, duke i quajtur ato ñeg±rsiraò.

Kryeministër, qytetarët thjesht po kërkojnë që ju ta kryeni një detyrë ndaj qytetarëve, që është njëkohësisht edhe e drejtë e juaja kushtetuese. Në njërën anë keni mbi 50 mijë protestues, që deri më tash kanë dalë në rrugët e shumë qyteteve të Kosovës, e në shumë e shumë qytete të tjerë do të protestojnë edhe tash e tutje, të cilët po kërkojnë shkarkimin e këtij ministri, ndërsa, në anën tjetër keni një minist±r, q± vazhdon tôi posht±roj± qytetarët dhe Republikën tonë.

Në anën e kujt jeni, zoti kryeministër? A do të thotë se për ty më rënd peshon një ministër i ardhur nga Parlamenti i Serbisë, sesa mllefi i nënave të të pagjeturve, më shumë se sa emrat e viktimave, që i fyen ky ministri yt, më shumë se sa gjithë qytetarët e Kosovës, që po protestojnë? A do të thotë se më shumë peshon një ministër i ardhur nga Parlamenti i Serbisë, se sa emrat e atyre viktimave, që i shkaktoi Serbia e këtij ministrit tënd?

Pra, bëhet fjalë për shkarkimin e një ministri, që po ta kërkojnë qytetarët tuaj, për një ministër që nuk të njeh as ty për kryeministër, as Kushtetutën e këtij vendi, madje nuk e njeh as emrin e shtetit, të cilin bashkë me shefin e vet, kryeministrin e Serbisë, e quajnë ñKosov± e Metohiò.

Bëhet fjalë për një ministër, i cili vjen nga Beogradi, me detyra të pa fshehura që Kosova tôi kthehet Serbis±. Vjen bashk± me shefin e tij kryeministri i Serbis± dhe, ngre n± mes t± Kosovës përmendoren e mbretit mesjetar e pushtues gjakatar Milutin, i cili njihet për pushtimet e tija barbare në Ballkan. Vjen këtu, pasi që Serbia më parë ka shkelur mbi përmendoret dhe emrat e dëshmorëve çlirimtarë shqiptarë në Preshevë, ku më pastaj në Bruksel nënshkruhet marrëveshja, që dolën Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, amnistomi i kriminelëve serbë dhe zgjedhjet nga të cilat doli Lista serbe e që të gjitha këto i përfaqëson ky ministri yt në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Bëhet fjalë për një ministër tëndin, që nga selia e Qeverisë së Serbisë kërcënon qytetarët dhe shtetin e Kosovës.

Kush është ky farë Jablanoviqi, i cili ka kaq shumë rëndësi e fuqi mbi ty, kryeministër? Shkarkoje këtë ministër fashist e këtë deputet të Serbisë dhe ktheje në kontejnerin e tij në Beograd! Ky nuk duhet të ketë vend në Qeverinë e vendit tim. Ose shkarkoje, ose ti bashkë me krejt Listën serbe shkoni bash ku të doni dhe ikni prej kësaj Qeveria, ku nuk e keni vendin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Edhe pse, kanë kaluar më shumë se dy javë nga deklaratat skandaloze të ministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Jablanoviqit, përkundër qytetarëve të Kosovës, në përgjithësi, ndërsa në veçanti kundër nënave të Gjakovës, të cilat në luftën e fundit çlirimtare humbën më të dashurit e tyre, situata pothuajse mbetet e njëjtë.

Jablanoviqi në këtë mënyrë po vazhdon të tallet duke na fyer të gjithëve, pa përjashtim. Atëherë, ne nuk kemi rrugë tjetër, përveç të besojmë se fakti se këtyre fyerjeve të këtij Jablanoviqit po u bashkohet edhe Qeveria e Kosovës në krye me Isa Mustafën, i cili nuk lejoi që çështja të shtrohet as në Qeveri, pra në Kabinetin e tij.

Po, si është e mundur që një qeveri e një kryeministri të ri, indiferent ndaj kësaj gjuhe përjashtuese, e një niveli të ulët qytetar e njerëzor, ndaj një populli të tërë, duke i quajtur madje, eg±rsira? A nuk do t± duhej, q± s± paku tôi thuhej k±tij njeriu me trupin n± Prishtin± e kok±n n± Beograd: ñjo zotëri, egërsira janë vetëm ata, që vrasin e masakrojnë civil± t± paarmatosur, madje dhe pleq dhe foshnje pak muajshò.

Si është e mundur, zëvendëskryeministër Thaçi, që brenda Kabinetit tuaj të mbani njerëz të tillë, që nuk i vret aspak ndërgjegjja për atë që bëjnë e flasin, të tërhiqen nga deklaratat fyese e poshtëruese e të kërkojnë falje, falje e vonuar e cila ishte më shumë poshtëruese.

Ministri Jablanoviq, para së gjithash ka fyer të gjithë qytetarët e Kosovës duke përdorur termin ñKosov± dhe Metohiò, pastaj ai pa fije turpi ka fyer protestuesit n± Gjakov±, duke i quajtur ñeg±rsiraò. Ai me deklaratat e tij n± vazhdim±si vazhdon me fyerjet edhe ndaj protestuesve gjakovarë, që çdo ditë po i bashkohen protestues nga mbarë Kosova.

Si është e mundur të jesh qytetar i Kosovës, të jesh ministër i Republikës së Kosovës e të mos kesh njohuri për 6 mijë persona të zhdukur, 12 mijë qytetarë të vrarë dhe rreth 20 mijë femra të dhunuara gjatë viteve ô98-ó99? ¢ô±sht± kjo paturp±si?

Gjuha e përdorur nga Jablanoviqi është fashizëm. 16 vjet më parë me terma të ngjashëm regjimi i Milosheviqit i arsyetonte të gjitha krimet e panumërta, që i bënte ndaj shqiptarëve në Kosovë. Jablanoviqi është ministër në Republikën e Kosovës, pra pjesë e një Kabineti qeveritar, të nj± shteti t± cilin nuk e njeh dhe e quan ñKosov± dhe Metohiò. Jablanoviqi është ministër, që paguhet nga taksat e qytetarëve të Kosovës, mijëra nga të cilët u vranë e u masakruan nga Serbia, shteti të cilit ai e përfaqëson brenda institucioneve kosovare.

Pra, kryeministër, në vend të deklaratave për ulje gjakrash, ju është dashur urgjentisht ta shkarkoni këtë ministër edhe pa kërkesën e qytetarëve, sepse jeni kryeministër, e keni dashur shumë këtë post, këtë karrige...

Mirë, me gjithë mend...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!
Të nderuar kolegë deputetë,

Javëve të fundit jemi dëshmitarë i një arsenalit të madh të akuzave shoviniste, që vijnë nga politika zyrtare e Beogradit, por edhe nga politikanë serbë të institucioneve të Kosovës.

Unë do të filloj me vizitën e Vuçiqit, ku në Kosovë gjatë qëndrimit të tij Kosovën e quajti ñdjep i Serbis±ò. Faktikisht, kjo i bie q± ne n± Kosov± nuk kemi institucione kredibile , p±r tôi dh±n± p±rgjigje këtij fjalori shovinist, fjalor i cili është përdorur me të madhe në fund t± viteve ó80-ta nga Milosheviqi dhe nga ky fjalor, ju e dini se ka arritur dhe ka kulmuar me një luftë, fjalor i cili ka bërë nxitje të urrejtjes ndërnacionale dhe ndërqytetore. Kjo po përsëritet edhe në këtë shekull, veçanërisht nga politikanët aktualë të jetës politike edhe në Kosovë edhe në Serbi.

Un± po mendoj se Isa Mustafa ka p±rgjegj±si kushtetuese, q± k±tij agresioni shovinist tôi japë përgjigje, në rast se nuk e ka lexuar, bile s± paku parafrazuar Fisht±n, se ñkur Mali i Zi me Serbi ish Iliriò, ne ishim k±tu dhe ju ishit n± Karpate t± Rusis±.

Më e keqja është se edhe vartësi i tij ministri, zëvendëskryeministri i Kosovës ngritjen e asaj p±rmendoreje, thot± se ñp±rmendoren e ngrem± n± Serbiò. N± fakt, -ka duhet ende tjet±r, q± Isa Mustafa ta respektoj± ligjin dhe tôi jap± p±rgjigje k±tij fjalori.

E keqja vazhdon edhe më tej kur Jablanoviqi vazhdon me fjalorin e tij, që tashmë e dinë të gjithë qytetarët dhe që folën edhe kolegët tjerë deputetë, fyen tepër rëndë domethënë nënat gjakovare, por edhe të gjitha nënat shqiptare të cilat kanë dhënë më të afërmit e tyre në luftën e fundit në Kosovë.

E keqja bëhet edhe më e madhe sikur Jablanoviqi të mos kishte jetuar në Leposaviq, po të kishte jetuar në Hënë dhe nuk e dinte se çfarë ka ndodhur në Kosovë, në anën tjetër, po i njëjti person e dinte se kush ka marrë pjesë në Luftën e Koshares dhe Pashtrikut.

Un± po mendoj se ±sht± momenti i fundit, q± ne tôia kthejm± dinjitetin institucioneve dhe vendit dhe të veprojmë dhe të kemi qëndrime konform ligjeve dhe Kushtetutës së vendit. Përndryshe, ky fjalor, ky qëndrim i Serbisë po prodhon kriza të natyrave të ndryshme, për shkakun se Vuçiqi po e bën edhe agjendën e Qeverisë dhe të Parlamentit të Kosovës, sidomos me ligjin e fundit p±r ñTrep-±nò. N± fakt, Vu-iqi paradite ka th±n± se seanca e Parlamentit të Kosovës do të shtyhet dhe ajo ndodhi dhe, ndryshimet e ligjit për ñTrep-±nò ishin m± shum± se befasuese, sepse t± nj±jtit njer±z, që e kishin iniciuar ligjin, të njëjtit. ..

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Sot po shfrytëzoj rastin që në këtë pikë ta shtroj një çështje që është ngritur vitin që shkoi nga dy kryetarë komunash, për më saktë të ushtruesit të detyrës së kryetarit të Medvegjës dhe kryetari i Kamenicës, që ka të bëjë me pikën kufitare Kapi, në fakt që ka të bëjë me hapjen ose rihapjen e një pike kufitare, që ka bllokuar banorët e asaj ane.

Kjo çështje tanimë, mendoj që mund të zgjidhet gjatë një procesi të bisedimeve teknike. Është mirë që zonja Tahiri të adresojë sa më shpejt që është e mundur këtë çështje. Mijëra banorë atje, tashmë janë të izoluar. Si rezultat i këtij izolimi, i këtij bllokim, janë shpërngulur nga ato zona. Vetëm dhjetë kilometra nga ajo pikë kufitare, që nuk do të duhej të ekzistonte është një banjë, e cila ka qenë burim i të ardhurave të asaj zone, kryesisht të frekuentuar nga shqiptarët.

Meqenëse, tashmë ajo ndalesë është vetëm për shqiptarët, ka rezultuar që të shpërngulen banorët e asaj ane nga të dy anët e kufirit, madje. Është mirë, që kjo çështje të adresohet sa më shpejt dhe meqenëse, po bëhet fjalë për kufijtë, ne e kemi një strategji për menaxhimin e integruar të kufijve. Pra, do të ishte mirë që jo vetëm nga aspekti i sigurisë, por edhe kryesisht nga aspekti human, të lirisë së lëvizjes, të trajtohet çështja e kufijve, madje edhe në disa vende tjera, ku kjo mund të bëhet pa pengesa të mëdha, siç janë kalimet kufitare që lidhin Gjilanin me Kumanovën, ose Deçanin me Plavën, e çështje të tjera.

Pra, ka di-ka q± mund t± b±jm± ne edhe pa disa pengesa t± m±dha, q± mund tôi kemi me Serbinë. Po, edhe njëherë po e ritheksoj, është mirë që kjo pikë kufitare, që është adresuar edhe njëherë nga këto komuna dhe nga banorët atje, të shtrohet sa më shpejt, meqenëse edhe infrastruktura ekziston, të bëhet i kalueshëm për shqiptarët, për qytetarët pa dallim, që jetojnë në atë zonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar katërmbëdhjetë pyetje parlamentare. Deputeti Ismail Kurteshi ka nj± pyetje p±r ministrin Jablanoviq. Ministri sôsht± k±tu, n± qoft± se dëshironi e keni fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Është mirë që kryeministri ta pyes ministrin, që të përcaktohet a do të jetë ministër në Qeverinë e Kosovës apo në Qeverinë e Serbisë dhe nëse është në Qeverinë e Kosovës, atëherë të marrë pjesë në seancat e Kuvendit të Kosovës. Unë nuk do ta lexoj sot pyetjen, sepse pres përgjigje prej tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kurteshi, prapë pyetje për zëvendëskryeministrin Branimir Stojanoviq. Sôsht± edhe ai. D±shironi ta merrni fjal±n? Zotit Kurteshi fjal±n, ju lutem. Në rregull.

Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!
Për pyetjen të cilën ia kam dërguar ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, më është përgjigjur me shkrim. Pyetja ka të bëjë me mamografin mobil të cilën e bëri edhe deputetja Alma Lama.

E falënderoj ministrin që është përgjigjur me shkrim, mirëpo në përgjigjen që e ka dhënë ministri ka thënë se ka pasur takime me Shërbimin spitalor klinik universitar dhe Klinikën e Radiologjisë, andaj më intereson të di- cilat masa obligative që i ka cekur, aty janë 5 masa, janë aplikuar prej momentit apo prej ditës që ma ka dhënë përgjigjen.

Po ashtu keni cekur, ministër se shpresoni se së shpejti mamografi mobil do të vazhdojë në shërbime sikur në ditën e daljes nga përdorimi, mirëpo populli, qytetarët shpresojnë, mirëpo ju jeni ai i cili do të merrni vendime për këtë çështje shumë të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit zoti kryesues!
Zoti kryeministër,
Kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
Duke falënderuar deputeten Baftija po edhe deputeten Lama për shqetësimin e ngritur rreth mamografit mobil, m± lejoni q± n± pika t± shkurtra pa ju marr± koh± tôju informoj se çështja e mamografit mobil ka qenë njëri nga angazhimet e mia intensive...

KRYESUESI: Zoti ministër, më fal që po ndërhyj, veç duhet, të paralajmëroj se 3 minuta i ke kohë.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Po, shpejt!... Ka qenë një nga angazhimet e mia më intensive që nga marrja e detyrës së Ministrit të Shëndetësisë duke ditur rëndësinë e funksionimit efikas të tij. Fillimisht kam ftuar, ashtu siç tha edhe deputetja, menaxhementin e Shërbimit spitalor, respektivisht përgjegjës të Klinikës së Radiologjisë në takim informues nga të cilët jam informuar se deri në ndërprerjen e punimeve, e funksionimit, mamografi mobil ka bërë 300 ekzaminime.

Ndërprerja e punës me këtë aparat ka ndodhur pas defekteve të shkaktuara si pasojë e ndërprerjes së furnizimit me rrymë, disa nga defektet e shkaktuara janë evituar menjëherë, ndërsa disa të tjera kanë marrë më shumë kohë.

Gjithashtu ju informoj se për këtë çështje janë interesuar edhe donatorët kryesorë të këtij projekti, ambasadori i Norvegjisë, ai holandez dhe të tjerët, me të cilët në takim jam zotuar se do tôi evitojm± problemet.

Në takimet me përgjegjësit janë ngritur çështjet të cilat është dashur të evitohen, ato çështje kanë qenë kryesisht teknike. Është bërë siguria fizike e mamografit mobil, janë evituar defektet të gjitha dhe janë marrë të gjitha masat për pajisjen e mamografit mobil për dalje në qarkullim si çdo automjet tjetër. Domethënë është regjistruar dhe është pajisur me dokumentacionin gjegjës.

Të nderuar deputetë,
Ju informoj se shfrytëzimi efikas i mamografit mobil në terren do të bëhet vetëm pas hartimit të detajuar të planit operative që duhet të koordinojë punët e nevojshme në Klinikën e Radiologjisë, përgjegjësit e spitaleve rajonale dhe drejtorive komunale të shëndetësisë me qëllim që të hartohen saktë oraret e lëvizjes së mamografit, caktimin e saktë të lokacionit dhe vend qëndrimin, njoftimin e grupeve target-qytetarëve që duhet të ekzaminohen dhe detalet tjera logjistike.

Për këtë arsye është caktuar një koordinator i cili do të përkujdeset për plotësimin e të gjitha kushteve teknike dhe harmonizimin e aktiviteteve të grupeve profesionale me aktivitetet lokale shëndetësore dhe të komunave.

Ju njoftoj sot mamografi mobil është në funksion, është duke u bërë ekzaminimi i grupeve të caktuara të cilat janë planifikuar më herët, ndërsa dalja në terren pritet pas planit të detajuar të qëndrueshëm dhe të implementueshëm, siç e thashë në koordinim me autoritetet lokale.

Sa i përket përgjegjësive, ju them që kur të marrim raportin nga organet e hetuesisë, sigurisht se do të merret edhe përgjegjësia ndaj individëve eventualisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, a keni pyetje shtesë?

KRYESUESI: Zoti Haradinaj! Pyetje p±r ministrin Haki Demolli. Ministri sôqenka k±tu. Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: E lëmë në seancën e radhës atëherë pyetjen!

KRYESUESI: Në rregull. Zoti Haradinaj prapë, ka një pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri sô±sht± k±tu.

DAUT HARADINAJ: Po meqenëse pyetjet janë bërë tash dy javë, i nderuar kryesues, edhe e kanë humbur kuptimin, megjithatë pyetja ka qenë për zjarrfikësit të cilët në dhjetë komuna akoma mbas 15 vjetësh trajtohen me koeficientin 4.3, që nënkupton domethënë këta njerëz nuk financohen si duhet, nuk mbështeten, në një vendim të ekzekutivit, janë transferuar nga niveli lokal në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa financimi i tyre bëhet në forma të ndryshme, domethënë në nivelin e Prishtinës funksion një njësi e veçantë që quhet Brigada e zjarrfikëseve, ndërsa në komuna, ta marrim shembull në 10 komuna të Kosovës: Skenderaj, Gjakovë, Drenas, Ferizaj, Dragash, Deçan, Artanë, Podujevë, Kaçanik e komuna tjera, koeficienti i zjarrfikësve, domethënë

rrogat e zjarrfikësve, janë 4,8, që nënkupton është më pak se një pastrues në Kosovë që e ka koeficientin 5,5.

Edhe un±, edhe n± t± kaluar±n, po edhe tash e p±rs±ris, mendoj q± ministri duhet tôi marr± masat urgjentisht pasi që janë domosdoshmërish domethënë janë me nevojë.

Krejt çka ka ndodhur për këta zjarrfikës deri tash janë vetëm ndihmat humanitare të cilat u kanë ardhur nga Komisioni Evropian e që unë i kisha falënderuar publikisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Abrashi.

AIDA DËRGUTI: Meqë tani jemi 10 muaj pas miratimit të Ligjit, i cili njeh statusin e personave të dhunuar gjatë luftës, nga mediet kemi dëgjuar që ka nisur të formohet Komisioni qeveritar për personat e dhunuar gjatë luftës mirëpo nuk kemi marrë asnjë informatë zyrtare në lidhje me këtë.

Andaj, zoti ministër, a i ka përfunduar Ministria të gjitha obligimet? Pra, a është formuar Komisioni qeveritar dhe a janë nxjerrë aktet nënligjore?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,
Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Deputetë,

Faleminderit për pyetjen!
Shkurtimisht një përmbledhje e përgjithshme, pastaj edhe një shpjegim se ku gjendet i tërë procesi.

Ligji 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, është miratuar siç e dini me 20 mars 2014 dhe i shpallur në dekretin.

Pas zbatimin e këtij ligji është paraparë nxjerrja e Rregullores për Komisionin qeveritar për njohjen e dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës.

Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, si bartëse ka hartuar draftin fillestar të projekt-rregullores për Komisionin qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës dhe ende nuk është themeluar komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e këtij statusi.

Kjo projekt-rregullore është në konsultim të brendshëm dhe së shpejti pritet të themelohet grupi punues i cili do të shqyrtojë dhe finalizojë projekt-rregulloren në fjalë ku do të marrin pjesë të gjitha grupet e interesit e gjithashtu edhe vetë Ministria e Punës dhe

Mirëqenies Sociale, për të cilën ne veç kemi nominuar një anëtar në këtë projekt-rregullore. Pasi Qeveria të themelojë komisionin qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës, si obligim, Komisioni pritet të themelohet se shpejti në përputhje me procesin e hartimit të rregullores me vendim të Qeverisë.

Sa për informatë të përgjithshme, Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës do të përbëhet nga 9 anëtarë: përfaqësuesi i Zyrës së kryeministrit, përfaqësues nga Ministria e Punës, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues nga Instituti për Krime Lufte, psikologë klinikë, psikiatër, juristë dhe përfaqësues nga shoqëria civile, me përvojë në veprimtarinë ndihmëse të kësaj kategorie.

Mund të shkoj edhe më tutje se qysh është menduar, në qoftë se kohë.

Përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të këtij komisioni do të jenë njohja dhe verifikimi i statusit të personave të dhunuar gjatë luftës siç parashihet në ligj, me plotësim-ndryshimin e Ligjit 04/L-54 për statusin e drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre.

Kompensimi dhe beneficioni që dalin nga ky ligj përfitohen pas shqyrtimit të rasteve nga Komisioni përgjegjës qeveritar dhe personat e dhunuar gjatë luftës përfitojnë benificione personale të parapara me nenin 6 të Ligjit që hyn në fuqi.

Gjithashtu përfitojnë edhe shërbime shëndetësore jashtë vendit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë zonja Dërguti?

AIDA DËRGUTI: Presidentja bashkë me UNWOMEN është angazhuar në draftimin e ligjeve sekondare lidhur me këtë çështje. Pyetja ime është, a jeni në bashkëpunim me presidenten, a jeni në dijeni për drafitimin e ligjeve sekondare dhe a do të raportoni në Kuvend veç e veç apo bashkërisht për këtë proces?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Ashtu siç e ceka, projekt-rregullorja është në hartim dhe në shqyrtim të brendshëm dhe me vendim të Qeverisë edhe do të hartohet dhe miratohet, si e tillë. Presidentja nuk merr pjesë në hartime të ligjeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj, pyetje për ministrin Rrahmani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, gjatë vitit 2012 është fokusuar në fusha tematike të cilat janë në interes për gratë.

Gjatë vizitave në terren të realizuara gjatë vitit 2011 në Kosovë, gratë nga OJQ-të e nivelit lokal, gratë asambliste po ashtu nga niveli lokal, si dhe gratë të cilat nuk janë të përfshira në asnjë organizatë kanë shfaqur brengosjen për shumë çështje që kanë të bëjnë me fuqizimin dhe pozitën e gruas, ndër to ishte çështja e shëndetit të gruas.

Nga të gjeturat në vizitat në terren të cilat përfshijnë dhe vizitën e Grave deputete në Institutin Onkologjik të Prishtinës, është cekur se gratë, posaçërisht gratë nga viset rurale nuk kanë qasje të duhur në shërbimet shëndetësore.

Për më tepër, Grupi i Grave Deputete është zotuar që do të implementojë një projekt i cili qëllimin kryesor e ka blerjen e një mamografi mobil. Pas dy vite punë dhe angazhim si dhe përkrahje nga shumë donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë mamografi mobil është blerë më 31 tetor 2014 dhe i mori përgjegjësitë si në vijim.

Ministër, pas një kohe të blerjes së këtij mamografi, një kohë shumë të shkurtër mamografi u prish. Përpos asaj që keni deklaruar në media se me rastin e mamografit po merret hetuesia, çka mund të na thoni konkretisht për këtë dhe kur do të hyjë në funksion mamografi mobil?

KRYESUESI: Zoti ministër, pyetjen e ke. Fjala është e juaja.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!
Zonja deputete, përgjigjen të përgjithësuar e dhashë pak më herët. Ju njoftoj edhe një herë që për defekt- dëmin që u ka shkaktuar me marrjen e kabllos nga dikush janë duke u marrë organet kompetente, ndërsa, ju them që mamografi sot është funksional dhe është duke u shfrytëzuar. Prej datës 12 janar deri sot janë kryer 54 ekzaminime shtesë mbi numrin 300 që janë ekzaminuar deri në ndërprerjen, respektivisht daljen nga përdorimi.

Mamografi mobil është në shfrytëzim dhe do të shfrytëzohet varësisht se sa mbërrin të koordinohen grupet profesionale të Klinikës së Radiologjisë me autoritetet vendore të komunave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E keni pyetjen e dytë zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Këto gjëra po ndodhin shpesh në Qendrën Klinike Universitare, por edhe në Shërbimin spitalor, sepse përpos mamografit mobil po prishen edhe teknologia tjetër e avancuar siç janë rezonancat magnetike, CT të cilat po dalin jashtë funksionit.

A ka krim të organizuar në Qendrën Klinike Universitare apo edhe në Shërbimin spitalor dhe zoti ministër, plani për veprim të mamografit mobil ka ekzistuar dhe kjo ka qenë me këtë renditje, në tetor, nëntor, në Qendrën Klinike Universitare, dhjetor: Podujeva, Drenasi, Graçanica, Fushë Kosova, Obiliqi, Ferizaj, Kaçaniku, Shtimja, Lipjani, Shtërpca, ndërsa deri sot përpos në Qendrën Klinike Universitare, që janë kryer disa sh±rbime ky mamograf sôe ka kryer asnj± sh±rbim.

Kush do të jetë përgjegjës për të gjitha ato veprime dhe gratë nëpër komuna që janë

lajmëruar se do të bëjnë mamografin mobil duke e ditur se ekzaminimi i hershëm i kancerit të gjirit shpëton jetë.
KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!
Ju them që me përgjegjësi sot në QKUK dhe në disa spitale rajonale, po edhe në kujdesin primar funksionojnë mamografët jomobilë dhe aty ekzaminohen pacientët nga mbarë Kosova, e nuk kemi të bëjmë me shkëputje të shërbimeve ose mosdhënie të shërbimeve për raste të tilla.

Mamografi mobil tash ka dalë prej përdorimit dhe plani që ka ekzistuar atëherë nuk ka mundur të implementohet për shkak të defekteve.

(Reagime nga salla)

Nuk ka mundur të implementohet edhe për çështje teknike, sepse është dashur të regjistrohet se ±sht± nj± boc±, q± ±sht± dashur tôi marr± tabelat p±r qarkullim dhe duhet tôi respektojë si të gjitha automjetet tjera rregullat e trafikut.

Në qendrat e mëdha shëndetësore ekzistojnë mamografët fiks. Mamografi mobil do të shfrytëzohet e do ta japë kontributin vetëm atëherë kur ne mund ta bartim nëpër lokacione ku nuk kemi mamograf fiks. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Pyetja e dytë, mendova që fillove me pyetjen e dytë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!
Para disa kohësh, nga Qeveria e Kosovës janë ndarë 5,5 milionë euro për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet kanceroze. Kjo shumë e parave të grumbulluara ka qenë nga refuzimi i deputetëve për rritjen e pagave, si dhe të personave të tjerë zyrtarë në nivelet e larta ku kanë punuar në Qeveri.

Pyetja parlamentare: Ministër, a mund të na japësh shpjegim - ku janë këto 5,5 milionë euro?

KRYESUESI: Zoti ministër Rrahmani, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!
Edhe kjo çështje është e interesit të veçantë për shëndetësinë. Ju them që në total në vitin 2014 janë ndarë me vendime të kohëpaskohshme 8 milionë e 139 mijë e 917 euro.

Për trajtim janë shfrytëzuar 7 milionë e 943 mijë e 577,28 euro,ose 97,9% e buxhetit të dedikuar për trajtim jashtë institucioneve publike. Numri i përgjithshëm i atyre që kanë përfituar në vitin 2014 është 889 persona.

Nga kjo shumë, për trajtim të fëmijëve me sëmundje malinje gjithsej 28 fëmijë. Janë shpenzuar 3 milionë e 737 mijë e 809 euro. Përveç kësaj, nga ky fond kanë përfituar edhe 281 pacientë të moshave të ndryshme, në shumën prej 1 milion e 180 mijë e 844 euro. Pra, shuma totale e shfrytëzimit të këtij fondi është 4 milionë e 918 mijë e 653 euro, përafërsisht 5 milionë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Ju falënderoj për sqarimin! Kjo shumë ka qenë e dedikuar kryesisht për fëmijët që vuajnë nga leukimia. Mirëpo, nëse i vizitojmë qendrat spitalore, Qendrën Klinike Universitare, ku hasim në mungesë të barnave nga lista esenciale, nga lista vitale, e të mos flasim për citostatikë, sepse çdo ditë po ballafaqohem me problemin, kur familjarët na adresojnë si adresë të tyre se po mungojnë citostatikët. Ne e dimë se një kurë e citostatikëve e ka një vlerë aq të lartë, një kosto aq të lartë, sa asnjë qytetar i Kosovës nuk mund ta përballojë një kosto të tillë buxhetore për ta paguar, dhe nëse ne si institucione dhe ju si ministër i Shëndetësisë nuk e aranzhoni që këto ilaçe të mos mungojnë nëpër qendrat klinike universitare nëpër spitale rajonale, atëherë besoni që njerëzit janë në hall të madh.

KRYESUESI: Zoti ministër, e dëshironi fjalën?

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!
Këtë vit 6 milionë euro janë të dedikuara për trajtim jashtë institucioneve publike për pacientët në nevojë dhe ju them që njëri nga objektivat që ka Ministria e Shëndetësisë është edhe furnizimi i rregullt i institucioneve publike me barna nga lista esenciale.

Posaçërisht, interesi do të fokusohet në citostatikë dhe barna të rëndësisë së veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e radhës është nga zonja Deliu, për ministrin Imet Rrahmani.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje për Kabinetin qeveritar dhe për deputetët,
Nga tri kolegët unë e mora përgjigjen lidhur me pyetjen time që është bërë dy javë më herët për çështjen e mamografit mobil. Kjo tregon që kur gratë marrin përgjegjësi për secilin projekt janë të përgjegjshme edhe karshi shkallës së përgjegjësisë edhe ministrat duhet të jenë ata që jo vetëm marrin masa, por edhe kujdesen që pajisjet e tilla brenda QKUK-së të mos ndodhë që të vidhen, sepse po krijohen manipulime dhe tendenca edhe te qytetarët, edhe tek investitorët, të cilët me shumë përkushtim kanë investuar për ta siguruar një mamograf mobil.

Ne e dimë që nëpër qendrat familjare nëpër Kosovë ka mamografë. Mirëpo, qëllimi për të cilën është bërë dhe kërkesa e donatorëve për ta siguruar një mamograf mobil ka qenë që ky mamograf të lëvizë nëpër të gjitha qendrat dhe nëpër të gjitha fshatrat dhe qytetet e Republikës së Kosovës. Presim që pas marrjes së përgjegjësisë ky aparat ta kryejë

funksionin për çka është sjellë dhe i është dhënë Ministrisë së Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!
Kjo tregon që shëndetësia ka shumë probleme dhe është e rëndësisë së veçantë, për atë arsye edhe është një nga prioritetet e Qeverisë. Unë dhashë përgjigje për mamografin, prandaj besoj që ne do të jem të kujdesshëm që të mos dalë prej funksionit dhe të shfrytëzohet për atë që është dedikuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zonjës Haxhiu, fjalën ju lutem!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Pyetja për kryeministrin e Kosovës është: Cilat veprime, zoti kryeministër, i keni ndërmarrë ndaj vartësve tuaj, konkretisht ndaj ministrit për Kthim dhe Komunitete, Jablanoviq, i cili me deklaratat e tij po i fyen në vazhdimësi nënat gjakovare, të cilave iu masakruan fëmijët nga ushtria, policia dhe paramilitarët serbë në luftën e fundit, duke e ditur se këto nëna gjakovare vuajtën dhe ju, kryeministër, me fyerjet që vazhdimisht ky ministër juaj, nuk ju mjaftuan ndoshta fyerjet e tij, për të deklaruar edhe ju se masakrat nuk filluan në Gjakovë. Unë e di që masakra kishte edhe në Lybeniq, edhe në Çyshk të Pejës, edhe në Reçak, edhe në shumë komuna të tjera, por ju them edhe ju, kryeministër, se nënat gjakovare dhe Gjakova në përgjithësi ka vuajtur shumë në luftë, por ju them që masakra më e madhe në Kosovë ishte masakra në Mejë, ku humbën 377 qytetarë brenda, jo vetëm një dite, por edhe për shumë pak orëve.

Andaj, kërkoj nga ju të tregon se çfarë masa ndërmorët, sepse e ndaluat edhe fjalën e lirë në Kabinetin tuaj. Pra, nuk e morët përsipër që të paktën të deklaroni edhe ju publikisht, apo ta merrni ndonjë masë të cilën e ka kërkuar me përgjegjësi shumë të madhe - shkarkimin, ky ministër.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po për fat të keq, ministri Jablanoviq u bë temë kryesore e Kosovës, e ne kemi plot tema tjera, kemi shumë probleme tjera. Mirëpo, edhe kjo temë e ka vendin e vet, e ka peshën e vet, e ka rëndësinë e vet dhe deklarata është mirë të dëgjohet dhe të vlerësohet në kontestin të cilin është dhënë dhe në kontestin të cilin është sqaruar nga ministri Jablanoviq. Unë nuk jam i detyruar që unë të sqaroj se çfarë ka menduar ministri, ose çfarë ka thënë ministri, por ai publikisht e ka sqaruar deklaratën e tij, ka kërkuar falje publike nga nënat gjakovare dhe të gjithë ata që kanë marr± pjes± atje, q± sôe ka menduar ashtu. Dhe, është çështje e përgjegjësisë së të gjithë neve për fjalën publike, të cilën e japim dhe për akuzat publike, të cilat i bëjmë.

Un± natyrisht q± sôdo ta lejoj asnj±rin, n± qoft± se do t± kishte argumente se ±sht± b±r± nj± fyerje e tillë për nënat gjakovare dhe për familjet e të pagjeturve. Mirëpo, mendoj që

ministri Jablanoviq e ka dhënë arsyetimin e tij dhe u ka kërkuar falje gjithë atyre që të mund ta kenë kuptuar në atë formë. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!
Do të thotë, e di që kemi shumë tema, por edhe ne e kemi ditur kryeministër edhe atëherë kur e kemi formua grupin, se nuk mjafton për ta udhëhequr Qeverinë e Kosovës të jesh vetëm ekonomist i diplomuar. E kemi ditë që nuk jeni i aftë për ta çuar vendin përpara. Andaj, edhe një herë kërkoj: Çfarë do të ndërmerrni nga ky ministër, i cili me trup është në Kosovë, me krye është në Beograd, i cili fyerjet që ua ka bërë nënave gjakovare dhe krejt qytetarëve të Kosovës, janë vetëm nisma çfarë ai tregon, duke u treguar i djallëzuar se nuk është në dijeni se çfarë ka ndodhur në Kosovë në luftën e fundit.

Andaj, edhe një herë kërkoj me përgjegjësi - çfarë ju do të ndërmerrni si kryeministër, sepse përgjegjësia është juaja. Ju jeni ai që i keni zgjedhur këta ministra, ose vartësit tuaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Zonja deputete,
Ju po flisni p±r ministrin Jablanoviq, nd±rkaq nuk po e korrigjoni veten dhe sôpo e kontrollin veten në akuzat dhe vlerësimet tuaja. Kush jeni ju që të vlerësoni se kush është ekonomist i dështuar, apo kush nuk është? Çfarë diplome më të madhe ke ti në ekonomi dhe -far± baze t± dijes m± t± madhe ke n± ekonomi, n± m±nyr± q± tôi t± vler±sosh se kush është i dështuar, apo kush nuk është i dështuar në pikëpamje profesionale?

Atë që e ka bërë Jablanoviqi atje, ti edhe disa të tjerë po e bëni këtu në Kuvend. Askush sôka t± drejt± k±tu tôi thot± dikujt se duhet t± shkoni n± burg, tôi thot± dikujt se jeni fashist±, tôi thot± dikujt se jeni kriminel±, n± qoft± se nuk keni fakte p±r ato, sepse t± gjithë ne po bimë në pozitë të njëjtë.

Prandaj, atë që e them - e them me përgjegjësinë time, e them me bindjen time dhe unë do të marr masa ndaj çdo ministri, në qoftë se ata do të kryejnë veprime, të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të bëjnë veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjet pozitive në Kosovë dhe do të bëjnë veprime, të cilat nuk e respektojnë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Për deklarime verbale dhe për gjëra të tjera, unë nuk mund të hyj dhe të jap vlerësime dhe të marrë masa. Ndërkaq për deklarime, të cilat janë në kundërshtim dhe të cilat janë cenime t± Kushtetut±s, cenime t± ligjit, masat duhet tôi marrin organet e drejtësisë. Ato janë të autorizuara që të marrin masa në fushëveprimin e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Është edhe një pyetje tjetër e zonjës Haxhiu për kryeministrin zotin Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë, zoti kryeministër, jam Teuta Haxhiu, deputete e Parlamentit të Kosovës. Se, pse keni dështuar, e kemi modelin e Prishtinës, por mbi të gjitha, edhe një herë po them, nuk mjafton të jeni vetëm ekonomist. Unë jam matematikane e diplomuar, mund të ju tregoj më shumë se ju për matematikën. Por, megjithatë, pyetja e radhës është:

Shkelja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga varësit tuaj po vazhdon edhe nga ministri i Administratës së Pushtetit Lokal, Mariq. Ndërsa ju absolutisht nuk ndërmerrni asnjë veprim. Pyetja është: Kur do të filloni ju si kryeministër i Republikës së Kosovës të kërkoni nga ministrat tuaj respektim të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Sa i përket Prishtinës, unë mburrem me Prishtinën, mburrem me punën e cila është bërë në Prishtinë, edhe ti si matematiciente mësoji numrat dhe mësoje si të veprosh me numra, e nuk është puna jote të japësh vlerësime për Prishtinës, sepse vlerësimet për Prishtinën i japin qytetarët e Prishtinës dhe i japin ata që ma kanë dhënë votën mua dhe që ma kanë dhënë besimin mua. Kështu që harroji ato punë, e merru me punët tua.

Sa u përket këtyre të tjerëve, çdonjëri do ta respektojë ligjin edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në qoftë se edhe ministri Mariq, por edhe një ministër shqiptar, nuk i respekton procedurat administrative, procedurat ligjore, ne do të marrim masa ndaj tyre.

Unë nuk kam informata se ministrat në Qeverinë e Republikës së Kosovës po veprojnë jashtë procedurave ligjore dhe procedurave administrative, të cilat janë të parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe me ligjet, të cilat janë në fuqi. Në qoftë se ti i ke argumente, urdhëro dhe thuaj ato, por unë informata të tilla nuk kam. Unë kam qenë i kam qenë dhe i kam vizituar disa nga këta ministra. Unë e kam parë flamurin e Republikës së Kosovës në zyrat e tyre, i kam parë simbolet e Republikës së Kosovës në zyrat e tyre dhe ata punojnë me letra dhe me dokumente të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!
Përgjigjen e kanë dhënë qytetarët e Prishtinës, por shqetësim shumë më i madh është se ju nuk jeni në dijeni, kryeministër i vendit, unë i kam argumentet, ja ku i keni kryeministër, po do tôjua jap edhe fizikisht. Po ju tregoj se n± nj± raportim q± ka pasur KTV-ja, ministri i Pushtetit Lokal, Lubomir Mariq, për dallim nga paraardhësi i tij, Slobodan Petroviq, ka vendosur që në njoftimet e kësaj ministrie të mos e vendosë logon e Republikës së Kosovës, raporton pra KTV-ja. Veprimi tjetër i tij është edhe bojkotimi i gjuhës shqipe në këto njoftime, e cila është gjuhë e parë zyrtare. Në disa prej tyre, në emër të ministrit, e ka dërguar Ilija Saviq, nuk përdoret fare gjuha shqipe. Njoftimi është vetëm në gjuhën serbe dhe në atë angleze, e askund nuk përmendet shteti i Republikës së Kosovës. A janë argument këto apo jo, kryeministër!

KRYESUESI: Zoti Kryeministër, dëshironi të përgjigjeni?

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po unë nuk merrem me KTV-në në Kuvend nuk merrem, moj zonjë! Nuk merrem me informata të KTV-së, unë merrem me dokumente zyrtare. KTV-në shfrytëzojeni ju, unë i kam dokumentet zyrtare. Lëre atë punë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli, pyetje për ministrin Zharku.

FATON TOPALLI: Faleminderit!
Ministër Zharku, pyetja që e kam në fakt është bërë para shumë ditësh, edhe pse ka pasur në Kosovë zhvillime të reja dhe shumë pyetje e pikëpyetje të reja, megjithatë po e shtroj. Pyetjen që po jua drejtoj vjen me kërkesën e banorëve që jetojnë përgjatë rrugës Ferizaj-Shtime, të cilët janë të alarmuar për shkatërrimin që kjo rrugë ka përjetuar në afat prej më pak se 90 ditësh dhe duan ta dinë se cilat janë arsyet e një prishje kaq të shpejtë dhe çfarë masash do të ndërmarrë Ministria për ta rregulluar këtë rrugë të rëndësishme, pavarësisht se këta banorë, me gjithë prishjen e rrugës, kanë siguruar se do të vijnë në protestën e nesërme, e cila do të mbahet në Prishtinë, kundër kolegut tuaj Jablanoviq dhe në përkrahje të kërkesave të minatorëve p±r kthimin e ñTrep-±sò n± nd±rmarrje publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zharku, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!
Zoti kryeministër,
Ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuari zotëri Topalli,
Projekti i Ministrisë për Infrastrukturë, rehabilitimi i rrugës nacionale N/25.3, segmenti Shtime-Ferizaj, ka filluar në korrik të vitit të kaluar dhe është projekt dyvjeçar, i cili do të përfundojë në qershor të këtij viti. Ekzekutuesi i punimeve është kompania ñPapemburg&Adriani Sojev±ò Ferizaj, nd±rsa vlera e kontrat±s p±r pun± ±sht± 1 milion e 544 mijë e 988 euro e 73 centë. Rruga ekzistuese e ka gjerësinë afërsisht 6,5 metra, ndërsa do të zgjerohet në 7 metra. Deri më tani, kompania e ka kryer shtresën e parë të asfaltit në trashësi prej 7 centimetra në tërë gjatësinë e rrugës prej 10 km e 300 metra. Shtresa e dytë e asfaltit prej 4 centimetrash ka filluar nga Shtimja në drejtim të Ferizajt, në gjatësi prej 2,6 kilometrash. Punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve klimatike dhe do të vazhdojnë në pranverë të këtij viti.

Deri tani, vëllim fizik i punëve është kryer në masën 58%. Gjatë këtij dimri janë paraqitur dëmtime në këtë rrugë, si plasaritje dhe hapje e gropave në sipërfaqe prej 1200 m2, e që janë pasojë e paraqitjes së ujërave nëntokësore. Duhet theksuar se nuk janë paguar me situacion të përkohshëm 700m2, me qëllim të eliminimit të defekteve të paraqitura dhe për shkak të dëmeve të reja eventuale. Sipërfaqja e dëmtuar gjithashtu nuk është llogaritur në vëllimin fizik të punëve të kryera.

Punëkryesi e ka sanuar gjendjen e dëmeve në këtë rrugë me mbushjen e gropave me asfalt dhe sanimin e plasaritjeve të paraqitura. Gjatë tërë kohës, kompania është duke kujdestaruar me qëllim të sanimit të dëmeve të tjera eventuale.

Kompania, me fillimin e punëve, është e obliguar të bëjë sanimin komplet të rrugës së dëmtuar, përfshirë shtresën asfaltit të dëmtuar dhe ta kryejë shtresën finale përfundimtare të asfaltit. Pas përfundimit të projektit, do të bëhet natyrisht pranimi teknik. Gjithashtu, duhet theksuar që në afatin garantues dyvjeçar nuk paguhet 10% e vlerës së projektit që të sanohen dëmet eventuale në afatin garantues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Faleminderit për përgjigjen, ministër! Ajo që më shqetësoi tash në këtë moment është fakti që ju thatë që rruga ka kushtuar 1 milion e 544 mijë e 988 euro e 73 centë euro, ndërsa sipas informacionit tim kjo rrugë e ka edhe një kosto shtesë, të cilën ju nuk e përmendni fare prej 153 mijë e 317 euro, që i bie se rruga në tërësi kushton 1 milion e 698 mijë e 305 euro e 73 centë, për çka ka mungesë të transparencës edhe sa i përket çmimit të mirëfilltë të rrugës.

KRYESUESI: Ministër! Në rregull! Deputetja Lama, pyetje për ministrin Abrashi. Besoj për mamogramin dhe...

ALMA LAMA: Jo, nuk e kemi për mamografin, por ju të mos ju vijë fare çudi për të, e për të cilin pyesin të gjitha deputetet, sepse është një angazhim i jashtëzakonshëm dyvjeçar i deputeteve dhe ndërkohë është prezantuar në publik sikur ne e kemi bërë ndonjë mëkat që e kemi siguruar mamografin. Kështu që është mirë që ministri i ka ndërmarrë masat të menjëhershme se do të ishte në qendër të kritikave dhe në të ardhmen. Po kështu, të mos ju vijë çudi ministrave dhe deputetëve që shumë nga pyetjet e deputetëve janë të ngjashme për arsyen e thjeshtë - se Qeveria ka funksionuar për një kohë të gjatë pa mbikëqyrjen parlamentare për shkak të krizës e tjerë.

Edhe pyetja ime lidhet është e ngjashme me zonjën Dërguti, lidhet me viktimat e luftës, dhunës seksuale gjatë luftës, në fakt, me implementimin e atij ligji, pa dashur të bie në përsëritje, dua ta pyes ministrin, duke qenë se ligji parashikonte që aktet nënligjore dhe krijimi i komisionit të bëheshin brenda 6 muajsh pas miratimit të ligjit, do të doja ta pyesja ministrin n±se rregullorja ose aktet n±nligjore q± tashm± kan± filluar tôi hartojn± kanë filluar nga ai, apo kanë qenë të përgatitura dhe kur parashihet që të përfundojë kjo punë, në mënyrë që ta fillojë punën edhe komisioni dhe identifikimi i grave, dhe duke qenë se ato janë në gjendje të mjerueshme, të përfitojnë sa më shpejt nga buxheti i miratuar për to pikërisht në vitin e kaluar. Kjo është pyetja ime.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abrashi, ke përgjigje? Përsërite edhe një herë, Alma! Në rregull, nuk ka përgjigje ministri. Do pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Pyetja ishte kjo, zoti ministër, pa dashur të bie në përsëritjen e pyetjes, kishte të bënte: Kur ka filluar puna për rregulloren, sepse në bazë të ligjit është dashur që

brenda 6 muajsh pas miratimit të ligjit të kryhej kjo punë dhe kur parashikoni ju që të përfundojë kjo punë, kur të fillojë komisioni, domethënë afatet ligjore, në mënyrë që ta dimë se kur këto gra të interesuara për të përfituar nga ky ligj do ta kenë mundësinë që të përfitojnë nga ndihma financiare? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën për përgjigje në pyetje.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!
Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Përgjigjja pak e ngjashme sikur edhe në pyetjen e mëhershme. Sa për informatë, besoj që në 6-mujorin e parë do ta finalizojmë punën e komisionit, kurse afati për ta parashtruar kërkesën, realizimin e të drejtave për pensione dhe benificione të caktuara sipas ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës do të jetë 5 vjet nga fillimi dhe zyrtarizmi i punës së Komisionit qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e fundit është nga deputeti Haxhiu, për ministrin Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues,
I nderuar ministër,
Çështja ka të bëjë me vështirësitë e qytetarëve për marrjen e shërbimeve kardiokirurgjike dhe të shërbimeve tjera. Ministria e Shëndetësisë në vitet e fundit ka investuar miliona euro në shërbimin e kardiokirurgjisë dhe shumë më pak në atë të kardiologjisë invazive. Ofrimi i këtyre shërbimeve ka pasur oscilime të mëdha dhe qytetarët e Kosovës kanë pasur vështirësi të trajtohen nëpër institucione publike për shërimin e tyre. Statuti i shërbimit klinik spitalor universitar, praktikisht dhe juridikisht, e ka shuar Qendrën Klinike Universitare.

Shumë klinika tani janë para kolapsit, si ajo e Kardiologjisë Vaskulare, e disa të tjera. Lista e pritjes për operime në këtë klinikë është e gjatë me vite dhe pyetja është: I nderuar ministër, a mund të na tregoni se sa ndërhyrje kirurgjike janë bërë në Klinikën e Kardiologjisë Vaskulare përgjatë viteve 2011 deri 2014? Pastaj, sa ndërhyrje kirurgjike janë bërë në ato investime të mëdha në Klinikën e Kardiokirurgjisë? Sa mjete janë investuar dhe sa pacientë janë trajtuar për këtë shërim jashtë institucioneve publike me paratë e Ministrisë të Shëndetësisë? Sa koronografi janë kryer, sa stenda dhe sa ... janë vendosur në Klinikën e Kardiologjisë, përkatësisht në Kardiologjinë Invazive gjatë viteve 2011-2014 dhe sa mjete janë shpenzuar për ofrimin e këtyre shërbimeve për pacientë jashtë institucioneve publike?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën! Po më duket sikur debat, me gjithë ato pyetje!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,
Fillimisht, i nderuari deputet Haxhiu, kërkoj falje që përgjigjja ime nuk mund të jetë komplete n± raport me k±rkesat e parashtruara p±r shkak t± koh±s s± shkurt±r p±r tôi marrë të gjitha informacione statistikore për 4 vjetët e fundit. Nëse nuk jeni kundër, u ishim p±rgjigjur n± nj± seanc± tjet±r, p±rndryshe mund tôjua jap vet±m disa sh±nime t± fundit dhe prioritetet të cilat i kemi këto ditë

Kisha propozuar që në seancën tjet±r tôjua jap nj± p±rgjigje t± plot±suar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit ministër!
Besoj që në seancën tjetër do të jesh më shumë më i përgatitur, por për informimin tuaj - nga viti 2007, i nderuar ministër, deri në vitin 2011, në Qendrën Klinike Universitare janë kryer 200 koronografi dhe 4 stendime, vetëm me shifra po flasim dhe me statistika, prej vitit 2011 deri në vitin deri në vitin 2014 janë kryer 2681 koronografi dhe 358 stendime. Kjo punë është kryer me shumë vështirësi dhe me pengesa nga Ministria e Shëndetësisë, e cila nuk ka bërë furnizime të duhura. Uroj që kjo të mos ndodhë në të ardhmen.

I nderuar ministër, para disa ditësh, me inicimin e drejtorit të Kardiologjisë, Qendra Klinike Spitalore dhe Universitare e ka ndëshkuar me masë disiplinore para përjashtim doktorin Sami Gjoka për shkak se ka folur në media për punën e tij profesionale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk është pyetje kjo, po përgjigjesh në vend të ministrit. Koha e pyetjeve është shteruar. Siç e dini, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Në sallë janë 85 deputetë të pranishëm.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,
Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 17 korrik, e vazhduar më 18 shtator dhe 8 dhjetor 2014; më 8, 9 dhe më 15 dhjetor; më 18 dhjetor dhe 22 dhjetor e 29 dhjetor 2014.

Nuk ka vërejtje. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 17 korrik, e vazhduar më 18 shtator dhe më 8 dhjetor 2014; 8 e 9 dhjetor 2014, 15 dhjetor 2014, 18 dhjetor 2014, 22 dhjetor 2014 dhe 29 dhjetor 2014.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura

Lidhur me rendin e ditës, po besoj, është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Unë ju kisha lutur që kjo pikë që është tash në radhë, e katërta, të jetë pas pauzës, për shkak se ministri i Punëve të Brendshme është në një takim me ministren e Punëve të Brendshme të Maqedonisë dhe nëse bën ta bëjmë në sesion të pasdites. Por, nëse ka gatishmëri, që dikush prej ministrave tjerë, atëherë unë sa po e shoh, në ndërkohë është i autorizuar zoti Abrashi, at±her± ne sôkemi asgj± kund±r q± t± vazhdojmë me këtë pikë. Kërkoj falje, atëherë, që e morra fjalën, por kështu ishte kërkesa, ndërkohë, e paska autorizuar zotin Abrashi dhe për ne është në rregull të vazhdojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqenëse është i autorizuar nga kryeministri, zoti Abrashi për ta paraqitur ligjin, fjalën e ka zoti Abrashi. Desha të ndërhyj pak që kur ka ndërrim ministrash, është mirë të njoftohemi me kohë, për paraqitje të ligjeve dhe atë me shkrim.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!
I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
Me qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe të sigurisë kombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme ka marrë iniciativë për hartimin e Projektligjit për përcaktimin e veprës penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacione të jashtme paraushtarake, ose parapolicore, në organizimet grupore apo individuale, jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në praktikën e deritanishme është vërejtur një trend i rritjes së individëve, të cilët me rritjen e vatrave të krizës në botë e me qëllim të realizimit të sferave të tyre të interesit po bashkëngjiten në formë të organizuar apo të pavarur në kryengritje apo konflikte të ndryshme jashtë vendit, për shuma të caktuara parash apo privilegje tjera.

Dhe, të njëjtit pas kalimit të kohës së caktuar kthehen në vend dhe bëhen bartës të aktivitetit propagandistik dhe nxitjes së të tjerëve për bashkim apo pjesëmarrje në forma të tilla. Pra, ne kemi konsideruar që është imediate krijimi i një kornize ligjore për ndjekjen dhe gjykimin e personave të tillë, që marrin pjesë në konflikte, apo në çfarëdo forme tjetër të organizimit joformal paraushtarak apo para policor jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Projektligji është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Shtetit, Gjykatën Supreme, Zyrën Ligjore të Kryeministrit dhe me Agjencinë Inteligjente të Kosovës dhe, jemi dakorduar plotësisht me dispozitat e këtij projektligji. Dënimet e parapara për kryerësit e kësaj vepre, sipas prokurorit të shtetit janë

adekuate, për kryerësit e kësaj vepre penale si dhe kontribuohet në parandalimin e përgjithshëm të këtij fenomeni, të dëmshëm për vendin tonë.

Është me rëndësi të potencohet se Projektligji kundër bashkimit në formacione të jashtme paraushtarake dhe parapolicore është hartuar në frymën e plotë të Rezolutës 2178 të vitit 2014, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit më datën 24 shtator 2014 dhe përmban të gjitha ato elemente ndëshkuese të kësaj rezolute, duke përfshirë sanksionimin lidhur me rekrutimin, financimin, planifikimin, përgatitjen, mbështetjen, sigurimin e fondeve dhe organizimin për kryerjen e kësaj vepre penale.

Të nderuar deputetë,
Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkojmë nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Të nderuar deputetë,
Pas paraqitjes së projektligjit hap debatin për diskutim në parim. Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Haradinaj, për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit me rekomandime.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,
Komisioni Funksional më datën 13 janar të vitit 2015, ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe ka konstatuar, se projektligji i plotëson kushtet e parapara në bazë të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit për ta proceduar për shqyrtim dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë.

Po ashtu, edhe në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i jap mbështetje këtij projektligji, gjithmonë duke pasur parasysh sepse ky ligj ka mundur të kalohet po ashtu, në Kodin e Procedurës Penale, sikur e kanë bërë shtetet e rajonit, por meqenëse ju është drejtuar ligj i veçantë, atëherë ne i japim mbështetje. Mendojmë, që është momenti i përshtatshëm që ta përkrahim këtë projektligj, duke pasur parasysh situatën se çka po ndodh edhe në vendet e krizës, siç u tha edhe më lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kalojmë te kryetarët ose te përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit dhe e përkrah në parim miratimin e tij.

Gjithashtu, v±rejtjet, sugjerimet dhe plot±simet e nevojshme do tôi paraqes± n± kuad±r t± Komisionit Funksional, atë për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës deri kur të vjen ligji në shqyrtimin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Nuredin Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkrah në parim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të Kosovës, në leximin e parë dhe, në vazhdim do të angazhohet në dhënien e vërejtjeve dhe propozim-amendamenteve për leximin e dytë.

Gjithashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së, në veçanti fton deputetët tanë në Komisionin Funksional, në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe FSK dhe komisionet e përhershme, që të japin kontributin në amendamentimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar ñVet±vendosjeò e ka fjal±n Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,
Qeveria e Kosovës ka sjell për diskutim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, me qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe të sigurisë kombëtare.

Ne jemi kundër shkuarjes, qoftë edhe të një shqiptari të vetëm për të luftuar në Siri apo në cilindo vend tjetër të botës, ku vepron terrorizmi. Jemi gjithashtu, thellësisht të interesuar të kemi rregullime ligjore, të cilat merren konkretisht me masat kundër terrorizmit të çfarëdo lloji.

Nuk ka dyshim se ndodhemi në një situatë kur duhet të marrim masa sigurie kundër terrorizmit. Shembulli i 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shembulli i fundit në Francë, pjesëmarrja e një numri të vogël shqiptarësh në luftën e ISIS-it, na thërrasin që të mos qëndrojmë duarkryq para kësaj situate dhe të ndërmarrim masat e nevojshme p±r tôi parandaluar pasojat n± vendin tonë dhe për qytetarët tanë.

Ne jemi prerazi kund±r grupimit t± quajtur óAl Kaidaô dhe grupimit Shteti Islamik apo çfarëdo organizate tjetër të ngjashme. Këto grupime bien ndesh me botëkuptimet tona politike për lirinë, për demokracinë dhe për organizimin shoqëror.

Lidhur me këtë çështje, Zvicra ka dhënë një shembull të mirë për të rregulluar këtë problem. Un± do tôi lexoj vet±m dy nene nga ligji zviceran kund±r terrorizmit, prej kat±r neneve, të cilat janë kryesore.

Neni 1 i Ligjit zviceran thotë: ndalesë. Ndalohen organizatat dhe grupimet në vijim:

a) grupi óAl Kaidaô,
b) grupi Shteti Islamik,
c) organizatat e maskuara apo vijuese t± grupimeve óAl Kaidaô dhe Shteti Islamik, si dhe organizatat dhe grupimet, të cilat në drejtim, qëllim apo mjete, përputhen me organizatat Alkaida, Shteti Islamik e tjera.

Neni 2 i k±tij ligji thot±: ñKushdo q± n± territorin e Zvicr±s dhe jasht± tij merr pjes± n± njërën prej grupimeve apo organizatave tjera, mbështet me njerëz dhe financa, organizon për to ose për qëllime të tyre aksione propagandistike ose i përkrah aktivitetet e tyre në forma t± tjera, d±nohet me heqje lirie prej 5 vitesh ose me d±nim me t± holla.ò

Ky ligj zviceran është i përcaktuar në kohë dhe vlen deri më 31 dhjetor të vitit 2018. Ligji që ka sjell Qeveria është aq i përgjithshëm, sa nuk hyn gati fare në funksion të luftës kundër terrorizmit. Për dallim nga Qeveria, ne jemi për atë që të luftohet konkretisht terrorizmi, që të përcaktohet qartë dhe me ligj se cilat janë organizatat terroriste dhe të dënohet kushdo që mbështet terrorizmin nga territori i Kosovës, pavarësisht nëse ka dy apo pesë pasaporta.

N± em±r t± Grupit Parlamentar t± L±vizjes ñVet±vendosjeò k±rkoj nga Qeveria e Kosov±s ta tërheqë ligjin dhe së bashku me të gjitha grupet parlamentare, ta bëjnë një ligj të ri, i cili hyn në funksion të çështjes, për shembull, të ngjashëm me të ligjin që ka një vend perëndimor, siç është Zvicra.

N±se Qeveria ka v±rtet vullnet p±r ta luftuar terrorizmin dhe jo p±r tôu dukur sikur e lufton terrorizmin, ndryshimi mund të bëhet shumë shpet, brenda dy orësh, brenda ditës. Pra, urdhëroni dhe tregoni, a dëshironi ta luftoni terrorizmin? A janë për Qeverinë dhe shumic±n parlamentare óAl Kaidaô dhe grupi Shteti Islamik organizata terroriste? P±r tôia dhënë kësaj edhe kontekstin e Kosovës, për shembull, a është vrasja e Selver Haradinajt në Mitrovicë akt terrorist?

A janë sulmet dhe ngjarjet e ngjashme sulme terroriste? A keni ndërmend ta luftoni vërtet bashkimin me organizatat terroriste, apo dëshironi të krijoni përshtypjen se jeni kundër tij?

Nëse jeni kundër terrorizmit, ejani ta përcaktojmë konkretisht dhe pa hamendje, cilat janë organizatat me veprimtari terroriste. Mos sillni projekte që trajtojnë 1.7 milionë qytetarë të Kosovës si të dyshuar për veprimtari terroriste. Ky ligj është i gjeneralizuar dhe nuk hyn në funksion të çështjes, të cilën pretendon.

Çfarëdo deklarimi publik rreth luftërave çlirimtare dhe vatrës së krizës mund të dënohet përmes këtij ligji. Ligji ndalon angazhimin për vlerat universale. Në botë janë zhvilluar dhe mund të zhvillohen luftëra të ndryshme të drejta, që nuk i bëjnë shtetet siç i ka bërë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila është mbështetur nga vullnetarë gjermanë, francezë, amerikanë, e të tjerë. Ligji është diskriminues dhe nuk trajton njësoj të gjithë qytetarët e

Kosovës, sepse serbët me shtetësi të dyfishtë kanë të drejtë të marrin pjesë në çfarëdo lufte, ndërsa shqiptarët që kanë një shtetësi, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë.

Ligji parasheh dënime drakoniane deri me 15 vjet burg, për veprat të cilat për shembull, ligji zviceran i sanksionon me gjobë, apo dënime heqje lirie deri në 5 vjet burg.

Nëse Qeveria e Kosovës nuk e tërheq këtë ligj, do të dëshmojë se nuk dëshiron ta luftojë me mjete efikase dëmin, q± mund ta p±soj± Kosova nga t± rekrutuarit potencial± t± óAl Kaid±sô dhe grupi Shtetit Islamik apo grupimet tjera, q± kan± q±llime t± ngjashme, por, që më shumë është e interesuar të krijojë përshtypjen gjoja sikur po lufton terrorizmin dhe të njëjtën koh± tôi ndjek±, p±rgjoj± dhe tôi b±j± si t± dyshuar qytetar±t e Kosov±s.

Pra, ky projektligj, së bashku me atë të përgjimeve, të komunikimeve elektronike, të cilin ne do ta diskutojmë më vonë, i krijon pushtetit një grup instrumentesh, ku në emër të sigurisë së vendit sigurojnë përndjekjen e cilitdo që mendon ndryshe nga Qeveria.

Për arsyet e lartpërmendura, ne do të votojmë kundër ligjit, sepse konsiderojmë, që terrorizmin duhet emëruar dhe duhet luftuar. Ne jemi të gatshëm, pra jemi të gatshëm për një ligj të mirëfilltë kundër terrorizmit, pra jemi 100% për një ligj të tillë.

KRYETARI: Faleminderit! Patëm një qëndrim të Grupit Parlamentar AAK. Do të vazhdojmë, në qoftë se nuk ka kundërshtim. Grupi Parlamentar Lista serbe. OK. Vazhdojmë, Grupi Parlamentar ñNismaò, fjal±n e ka Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar ñNismaò e mb±shtet Ligjin n± parim dhe duhet ta ritheksoj se gjatë debatimit në Komisionin për Siguri kam mbajtur një qëndrim ku kam kërkuar mirëkuptim edhe nga deputetët edhe në këtë rast po e përsëris se ky ligj është i nevojshëm edhe pse ka ligje tjera që i luftojnë dukuritë devijuese negative të shoqërisë, por mendoj se ligji në nenin 1, domethënë është shumë i përgjithësuar dhe po besoj se gjatë amendamentimit do ta japë kontributin që ligji të jetë më preciz. Për shembull, këtu ku flitet që qëllimi i ligjit duhet të jetë mospjesëmarrja në luftërat në Lindjen e Mesme ose eventualisht edhe mospjesëmarrja në luftëra ku mekanizmat ndërkombëtar si OKB, NATO, Bashkësia Evropiane apo mekanizmat tjerë, i cilësojnë ato luftëra si terroriste, okupuese e kështu me radhë.

Përndryshe jemi që Kosova ta ketë një ligj të kësaj natyre dhe për faktin se është edhe një Rezolutë e OKB, pavarësisht se Kosova nuk është anëtare e atij mekanizmi ku shtetet sugjerohen që të kenë qëndrim ndaj luftërave, për shembull si luftës që është duke ndodhur në Lindjen e Mesme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga ñ6+ò, Danush Ademi e ka fjal±n.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!
Grupi ñ6+ò e ka shqyrtuar projektligjin n± fjal±, n± parim do ta p±rkrah± k±t± projektligj, v±rejtjet e veta do tôi jap± n±p±r komisionet p±rkat±se.

KRYETARI: Atëherë, kalojmë në pjesën e debatit ku janë të lajmëruar deputetët. E ka fjalën Enver Hoxhaj.

ENVER HOXHAJ: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar zonja e zotërinj,
Zoti Demaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e prezantoi qëndrimin e tij dhe Partia Demokratike e Kosovës e mbështet me urgjencë miratimin e një ligji të tillë.

Mendoj që një ligj i cili është prezantuar në një rrafsh politik synon mbi të gjitha që ta parandalojë pjesëmarrjen e qytetarëve tanë në konflikte të armatosura jashtë vendit dhe dihet gjeografia e këtyre konflikteve.

Në një rrafsh penal, ky ligj synon që të parasheh masa për vepra të caktuara penale që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen, me rekrutimin dhe me çdo gjë që lidhet me një fenomen të tillë. Dhe, unë mendoj që ligji është i domosdoshëm, jemi vonë dhe duhet të miratohet me urgjencë dhe ky ligj është pothuaj se i njëjtë sikurse një ligj i tillë është miratuar edhe në vende të rajonit, mirëpo tema për të cilën ne sot po bisedojmë është temë ma komplekse dhe reagimi i shtetit për mendimin tim duhet të jetë shumë më dimensional.

Më lejoni ta bëj një pyetje të thjeshtë që ta kuptojmë se sa komplekse është kjo temë.

Pse shkon dikush ose disa në një konflikt të armatosur në Siri apo në Irak kur ka plot të tillë që shkojnë të cilët nuk janë në gjendje ta gjejnë në hartë se ku janë këto vende, nuk e dinë në hartë se ku gjenden këto vende. Pse shkon dikush në një konflikt të cilin nuk e kupton? Pse shkon dikush n± nj± konflikt q± sôka t± b±j± as me historin± e tij, as me kulturën e tij, as me identitetin e tij.

Kosova në rrafshin politik ka qenë pjesë dhe është pjesë e koalicionit botëror kundër ISIS-it apo DESH si i thonë në gjuhën arabe, deklarata e djeshme e sekretarit Kerry është vlerësim për sjelljen shtetërore të Republikës së Kosovës. Veprimet që janë ndërmarrë nga policia dhe gjyqësia kanë qenë të domosdoshme dhe për mendimin tim ka qenë koha e fundit, mirëpo këto veprime ndodhin brenda përbrenda territorit të Republikës së Kosovës, a fenomeni është rajonal, fenomeni është global dhe si i tillë është një kërcënim i cili jo vetëm që mund të paraqesë rrezik për Kosovën sot, por është diçka që mund të paraqet rrezik për Kosovën, për rajonin dhe për shtetet demokratike edhe në të ardhmen. Në këtë drejtim nuk duhet të jemi naiv.

Por para edhe se të ndodhë pjesëmarrja dhe shkuarja e disa qytetarëve të Kosovës në konfliktet e tilla të armatosura, ne e dimë që nga fundi i luftës, nga viti 1999 ka pasur grupe radikale të cilat kanë paraqitur një lloj kërcënimi për sigurinë e Kosovës dhe këtu mendoj që si deputetë të Kuvendit të Kosovës duhet të jemi të sinqertë me njëri- tjetrin.

Prandaj, unë mendoj që ne duhet të lëvizim përtej ligjit. Unë mendoj që Qeveria duhet ta sjell një dokument që ka të bëjë me sigurinë kombëtare, që politika e brendshme, politika e jashtme, mbrojtja, drejtësia duhet të adresojnë një fenomen të tillë.

Ne duhet tôi parandalojm± kushtet ose ne duhet ta parandalojm± fenomenin e krimit, t± kushteve dhe të motiveve, sepse njerëzit nga Kosova marrin pjesë në konfliktet e tilla, edhe pse jam i vetëdijshëm që motivet mund të jenë të llojllojshme. Do të thotë duhet një qasje ndërinstitucionale ku ministritë e ndryshme, agjencitë e ndryshme, roli i familjes, roli i arsimit, roli i medieve duhet të jetë shumë kyç. Duhet po ashtu Bashkësia Islame ta ketë një rol shumë të rëndësishëm në të ardhmen dhe sot që të parandalohet një fenomen i tillë.

Që të jem më i qartë, arsyeja pse dola në foltore është që ne duhet ta kemi një dokument të sigurisë kombëtare të cilin Kosova nuk e ka, kemi lloj- lloj strategji, i cili përcakton qëllimet jetike të sigurisë çka është siguria, i cili buron burimet e kërcënimit dhe rreziqet, i cili i përcakton mjetet të cilat duhet të përdoren kundër këtyre rreziqeve si koalicion dhe me deputetë që i kemi në sallë dhe me ekspertizën që e kemi në sallë dhe në këto institucione besoj që diçka të tillë mund ta parandalojmë.

Nuk ka vetëm pjesëmarrje të qytetarëve të Kosovës nga vendi ynë në gjeografi të Lindjes së Mesme. Ka edhe në Ukrainë, nga veriu i Kosovës, nga komunat e veriut të Kosovës marrin pjesë në grupet rebele që e kërcënojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Në këtë drejtim, duhet të lëvizim përtej sigurisë fizike për qytetarët, duhet të lëvizim edhe përtej asaj se si ta mbrojmë vetëm sovranitetin dhe rendin kushtetues, po duhet të shohim se si tôi mbrojm± edhe vlerat tona demokratike. Siguria komb±tare ka t± b±j± edhe me vlera të brendshme të shtetit, ka të bëjë edhe me vlerat sekulare të shtetit. Ne jemi shtet sekular të definuar në Kushtetutën tonë.

Dhe më lejoni të përfundoj. Dikush i cili shkon në një konflikt, në një vend të cilin ndoshta nuk mund ta gjejë as në hartë, mund të na dëmtojë aq shumë saqë në pjesë të ndryshme të botës të tjerët ta keq perceptojnë se ku gjendemi ne në hartë. Dhe, kjo mund të sjell në një degradim gjeopolitik të vendit tonë, mund të sjellë në një kompromet im të vendit tonë. Prandaj, ligji duhet të miratohet, por Qeveria duhet të lëvizë përtej ligjit dhe duhet ta kemi një qasje ndër sektoriale që mund ta ofrojë vetëm një dokument i sigurisë kombëtare të cilin shteti i Kosovës qe shtatë-tet± vjet sôe ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli, replikë!

FATON TOPALLI: Faleminderit!
Zoti ish-ministër, respektivisht deputeti Hoxha tha që pjesëmarrja e grupeve terroriste të pjesëtarëve nga Kosova, është e hershme. Mjerisht, përkundër faktit që ne kemi në Kodin Penal një pjesë të tërë e cila ka të bëjë me terrorizmin deri tash r3u4(rk67(pjes)-8(ë)4( )-69(të)-7( )-66H-7